

# **Parimet e doktrinës së krishterë**

**O. J. Gibson**

© E drejta e autorit: Asambleja Biblike Pogradec

Pa autorizim nga autori nuk lejohet  
shtypja apo riprodhimi i tekstit.

Citimet biblike janë nga bibla «Diodati i Ri» (1991 - 1994).  
Përdorur me leje nga ALBANIAN BIBLE SOCIETY - A.B.S., TIRANË

Asambleja Biblike 2004  
Pogradec

Sa shpesh e pyesim veten: “Vras mendjen se çfarë mendon Perëndia për këtë?” ose gjatë një bisede mendojmë se diçka është duke u paraqitur keq për Perëndinë apo për Biblën, por nuk e dimë vërtet se çfarë të themi ose ku t'i gjejmë përgjigjet?

Perëndia thotë: “Bli të vërtetën dhe mos e shit” (Fjalët e Urta 23:23). Bibla na tregon se ajo është zbuluesja e drejtpërdrejtë e Perëndisë dhe që prej saj mund të dimë se çfarë dëshiron Ai që ne të kuptojmë. Një pjesë e së vërtetës që blejmë vjen në formën e dëgjimit apo mësimin në të mbledhurit bashkë të dielën ose përmes radios a një konference, por një pjesë e madhe e së vërtetës që ne mund të blejmë vjen kur ne personalisht i hapim zemrat dhe mendjet tona para Fjalës së Gjallë të Perëndisë, që të dëgjojmë prej Tij dhe të kuptojmë të vërtetën e Tij.

Një mënyrë shumë e mirë për ta bërë këtë është përmes studimit të Biblës *Parimet e doktrinës së krishterë (PDK)*. Ky studim 13 javësh trajton këto tema:

1. FJALA JOTE ËSHTË E VËRTETA - Bibla si mesazhi unik i Perëndisë drejtuar njeriut
2. PERSONI I PERËNDISË - Prova për ekzistencën dhe personalitetin e Perëndisë
3. PËRNGJASIMI I PERËNDISË - Si është Perëndia, atributet e Tij
4. TË KUPTOSH NJERIUN - Origjina, qëllimi dhe përgjegjësia e tij
5. PROBLEMI I MËKATIT - Përkufizimi, origjina dhe pasojat
6. SHQYRTOJMË PËRJETËSINË - Dy pikëmbërritjet e njeriut. Jeta mbas vdekjes
7. JEZUS KRISHTI: PROVIDENCA E PERËNDISË - Ardhja e Tij e parathënë. Hyjnia dhe njerëzimi i Tij
8. DOMETHËNIA E KRYQIT - Çfarë realizoi Krishti përmes vdekjes dhe ringjalljes së Tij
9. LINDJA E RE - Domosdoshmëria, mënyrat dhe rezultatet e të qenit “i lindur sërish”
10. SHPËTIMI NËPËRMJET HIRIT - Si të shkosh në qiell pa qenë një njeri fetar
11. TË BESOSH TE JEZUS KRISHTI - Domethënia e besimit të vërtetë. Besimi që bën ndryshimin
12. SIGURIA E SHPËTIMIT - Si të jesh i sigurt për jetën e përjetshme
13. TË JETOSH JETËN E RE - Parime të jetës së krishterë

Burimi i së vërtetës në tërë këta kapituj është Bibla. Çdo javë të duhet rreth 1-2 orë për të investuar në leximin dhe përgjigjet e pyetjeve, një studim i thjeshtë prej 3 pyetjeve për t'ua bërë disa njerëzve dhe të mblidhesh bashkë në një nga Grupet tona të Vogla për të gërmuar me të tjerë atë që mësojmë. Mund të jetë një investim shumë i frytshëm!

Nëse jeni të interesuar për t'u bashkuar me ne, ejani në një nga Grupet e Vogla ose na bëni një vizitë të dielën dhe do të sigurojmë librin e studimit për përdorimin tuaj. A keni ndonjë shok apo shoqe që do të ishte i/e interesuar për të njohur atë thotë fjala e Perëndisë? Merreni me vete!

## FJALA JOTE ËSHTË E VËRTETË

«KUSH ËSHTË PËR TË VËRTETËN E DËGJON ZËRIN TIM» tha Zoti Jezus para guvernatorit romak. «Pilati i thotë: Çfarë është e vërteta?» (Gjo. 18:37-38). Përfitojmë shumë pak, zakonisht, nëse studiojmë diçka në të cilën mendojmë (1) nuk ka asnjë të vërtetë që mund të quhet e tillë, ose në të cilën (2) është një e vërtetë që ndryshon vazhdimisht, ose në të cilën mendojmë (3) është e pamundur ta njohësh të vërtetën me siguri. E vërteta është e përcaktuar si: e njëjtë me faktet apo me realitetin, pajtohet me atë që është, që ka qenë e që do të jetë: është e kundërta e rrenës, e gabimit apo e gënjeshtërs. E vërteta është e saktë dhe e pandryshueshme, pavarësisht nga historia dhe kultura; është absolute dhe e pavarur nga të gjitha gjërat e tjera. Të besosh ndryshe është shkatërruese si për mbushjen e bagazhit tonë kulturor ashtu edhe për atë moral.

### Kërkimi i së vërtetës

Psalmisti thoshte: «Më udhëhiq në të vërtetën tënde dhe më mëso» (Psalmi 25:5). Ai besonte që kjo e vërtetë ishte e përjetshme (Psa. 117:2). Duke parë që ajo është kaq e çmuar, na jepet një rekomandim: «Merre të vërtetën dhe mos e shit» (Fjalët e Urta 23:23). Profeti flet për «Perëndinë e së vërtetës» (Isa. 65:16). Zoti Jezus thotë: «Unë jam ... e vërteta» (Gjo. 14:6) dhe «fjala jote është e vërtetë» (Gjo. 17:17). Nga ana e Perëndisë është dëshira që të gjithë njerëzit «ta njohin të vërtetën» (1 Tim. 2:4). Pastaj na thuhet që njerëzit, në përgjithësi «kanë ndryshuar të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtëri, dhe kanë adhuruar e i kanë shërbyer krijesave në vend të Krijuesit» (Rom. 1:25). Ata që thonë që janë në kërkim të së vërtetës shpesh nuk e duan të vërtetën (2 Thes. 2:10) kërkojnë më shumë rrugën e tyre dhe kjo rrugë nuk është rruga e drejtë. Por Jezusi atyre që me të vërtetë kërkojnë të vërtetën i ka premtuar: «Do të njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë» (Gjo. 8:32). Njerëzit duhet ta njohin të vërtetën rreth Perëndisë, rreth jetës dhe përjetësisë.

### Burimi i së vërtetës

Ku ta kërkojmë të vërtetën? Disa e kërkojnë brenda vetes; besojnë që arsyeja e tyre, emocionet, dëshirat e tyre janë një udhërrëfyes i mjaftueshëm. Disa të tjerë e kërkojnë të vërtetën në marrëdhëniet me të tjerët; i japin shumë peshë këshillave, eksperiencave dhe mësimëve të personave të tjerë. Disa të tjerë e kërkojnë të vërtetën përtej vetes së tyre, janë të bindur që kuptimi i së vërtetës shkon përtej aftësive të kufizuara që ka intelektin e zgjuarsia njerëzore.

Duhet ndihma e Perëndisë ose e ndonjë fuqie mbinatyrore. Vepra që Perëndia kryen duke na komunikuar disa gjëra të përcaktuara, që ndryshe nuk do t'i kishim njohur, quhet zbulim. Ndërsa quhet frymëzim vepra e kryer nga Perëndia duke udhëhequr njerëzit për të shkruar një komunikim të së vërtetës që Ai do të na e zbulojë. Fakti që Perëndia ka vepruar pikërisht në këtë mënyrë për të na dhënë 66 librat e Biblës, është përcaktuar nga profetët, nga apostujt, e nga Jezu Krishti vetë.

Zbulimi i Perëndisë është quajtur «Shkrimi» ose «Shkrimet» (Marku 12:10; 12:24) duke na lënë të kuptojmë që flitet për shkrime të shenjta. Ne e quajmë bashkësinë e këtyre librave Bibla, që do të thotë librat ose më mirë, «Libri» - duke treguar për shkëlqesinë e tij qëndrueshmërinë e tij përmbi gjithë librat e tjerë. Këto shkrime më vonë do të emërohen «Fjala e Perëndisë» (Marku 7:13; Rom. 10:17; 2 Kor. 2:17; 1 Thes. 2:13; Heb 4:12). Shprehje të tilla si «Perëndia thotë», «Zoti foli» dhe «fjala e Zotit u bë e njohur» janë përdorur vetëm në Dhiatën e Vjetër rreth 3000 herë. Në shumë raste shikojmë që Perëndia flet direkt (Eksodi 24:12; Ligji i Përtërirë 10:1-2). Shkrimtarët e Shkrimit thonin që Perëndia po jepte fjalët e Tij njerëzve nëpërmjet tyre. Shiko shprehjet e mëposhtme të sjella nga njerëzit e Perëndisë në Bibël:

Moisiu:	«Perëndia tha: “I Përjetshmi tha”» (Eksodi 3:14-15, LiP 1:42).
Jozueu:	«Zoti foli» (Jozueu 1:1)
Jeremia:	«I Përjetshmi tha: “thotë i Përjetshmi”» (Jer. 1:7-9)
Ezekieli:	«Ai më tha» (Eze. 3:4)
Malakia:	«Thotë i Përjetshmi» (25 herë)

- Jezusi: «derisa të plotësohet gjithçka» (Mt. 5:18, duke folur për ligjin e Dhiatës së Vjetër).  
 «urdhri i Perëndisë» (Marku 7:8, në përputhje me ligjin e Dhiatës së Vjetër).  
 «Është e shkruar» (Gjo. 6:45, duke folur për profetët e Dhiatës së Vjetër).  
 «Kanë Moisiun dhe profetët» (Luka 16:29-31).  
 «të shkruara ... në ligj ... tek profetët dhe tek psalmet» (Luka 24:44).
- Apostujt: «(profecia e Shkrimeve) e lajmëruar nga Fryma e Shenjtë» (Veprat 1:16)  
 «Dhe foli Fryma e Shenjtë» (Veprat 28:25)

Përveç këtyre bëhen pohime të tjera të karakterit të prerë si: «Çdo Shkrim është i frymëzuar nga Perëndia» (2 Tim. 3:16); «njerëzit kanë folur nga ana e Perëndisë, sepse janë shtyrë nga Fryma e Shenjtë» (2 Pje. 1:21); «jo me fjalë të mësuara nga dija njerëzore por të mësuara nga Fryma» (1 Kor. 2:13).

### Vula e së vërtetës

Konsideratat e mëposhtme tregojnë që përcaktimet e mësipërme janë të vërteta;

1. Ata që këmbëngulnin se ishin të frymëzuar ishin njerëz me cilësi shumë të larta morale e shpirtërore. Kush guxon të akuzojë Moisiun, Palin, Isaian ose deri Zotin Jezus se janë njerëz me cilësi të diskutueshme?
2. Bibla zotëron një unitet të thellë mësimi, megjithëse e shkruar nga më shumë se 40 shkrimtarë të ndryshëm, në një hark kohor që i kalon 1500 vjetët. Në ç'menyrë tjetër mund ta shpjegojmë këtë unitet?
3. Paraqitja, në Shkrimet, e një numri të madh faktesh historike ka nxitur përpilimin e volumeve në bazë të zbulimeve arkeologjike dhe të vërtetave të tyre. Në fakt janë në Bibël referime të gjëra për ngjarje e personazhe historike.
4. Bibla ka vazhduar së qeni, për botimet e panumërta, për përhapjen e gjerë të saj dhe për ndikimin e madh që ka në botë, libri më i rëndësishëm i shkruar ndonjëherë. Por ka qenë edhe libri më shumë i luftuar, e megjithatë, ka mbijetuar ndaj tentativave të panumërta e të kota për të djegur çdo kopje. Kush libër tjetër, me një kundërshtim të tillë, mund të kishte mbijetuar? Dhe në fakt ka vazhduar të jetë libri më i shitur, vit mbas viti.
5. Ky libër vazhdon të ndryshojë jetë njerëzish edhe sot. Kriminelë të egër, ashtu edhe njerëzit më të urtë, janë prekur e ndryshuar rrënjësisht nga mesazhi i tij. Miliona njerëz kanë marrë nga Bibla shpresë, ngushëllim e inkurajim në momentet më të trishtueshme. Kush libër ka ndryshuar për të mirë kaq shumë jetë?
6. Profeci të përshkruara në çdo detaj janë përmbushur njëqind për qind. Në ç'vend tjetër gjenden dokumente profetike të plotësuara njëqind për qind?

Argumente të rëndësishme si jeta e përjetshme kane ngurtësuar pa dobi mendjen e njerëzve të mëdhenj. Vetëm në Shkrimet ato përballohen dhe zgjidhen.

Qëllimi i këtyre mësimëve është të ndihmojë lexuesin të kuptojë saktësisht atë që Bibla na mëson mbi argumente si p.sh. Perëndia, njeriu, mëkati, shpëtimi, përjetësia dhe Jezus Krishti. Është e rëndësishme të dish atë që thotë Bibla para se të pranosh me atë që thuhet. Jezusi këmbëngulte fakteve që ata nuk njihnin Shkrimet (Mt. 22:29). Danieli thotë që këto ishin Shkrimet e «librit të së vërtetës» (Dan. 10:21). E njeh ti të vërtetën?

### Pyetje - Mësimi 1

Njeriu zotëron një dëshirë të madhe për të njohur të vërtetën. Janë të disponueshme shumë burime për të, megjithatë nuk janë të besueshme. Bibla pohon që është e vërteta e Perëndisë e shfaqur për njeriun.

1. Cila nga frazat e mëposhtme e përshkruan më saktësisht konceptin biblik të së vërtetës? (Zgjidh një)
  - a. nuk ekziston asnjë e vërtetë
  - b. e vërteta ndryshon vazhdimisht
  - c. është e pamundur ta njohësh të vërtetën me siguri
  - d. e vërteta njihet dhe është absolute

2. Në ç'mënyrë Perëndia ia ka komunikuar të vërtetën njeriut, përpara lindjes së Krishtit (Heb. 1:1)?

Çfarë theksonin profetët mbi prejardhjen e fjalëve të tyre?

3. Kush është mjeti final i përdorur nga Perëndia për të komunikuar të vërtetën (Heb. 1:2; Mt. 17:5)?

Çfarë thotë Jezusi mbi të vërtetën (Gjo. 14:6; 17:17)?

4. Në ç'mënyrë Jezusi thekson autoritetin e anëtarëve të Shkrimeve të Dhiatës së Vjetër (Luka 24:44)?

Çfarë qëndrimi merr Jezusi në drejtim të ngjarjeve të mëposhtme të Dhiatës së Vjetër?

Krijimi i Adamit dhe Evës (Marku 10:6)

Jona e peshku (Mt. 12:39-40)

Noeu dhe arka (Mt. 24:37-39)

5. Përse nuk shkon të thuash që pranoj mësimet e Jezusit dhe ndërkohë refuzon mësimet e pjesëve të tjera të Biblës, p.sh. Zanafillën (Gjo. 5:46-47)?

6. Shkrimtarët e Dhiatës së Re i bënë me shkrim fjalët e mësimet e Jezusit. Çfarë qëndrimi mbajtën ata në lidhje me autoritetin e asaj që ata po shkruanin (1 Kor. 11:23, 2 Pje. 1:16-21)?

7. Kush ishte një nga gabime trashanike të kryetarëve fetar në kohën e Jezusit (Mt. 22:29)?

8. Shkruaj me fjalët e tua 2 Tim. 3:15-17.

Kush është një nga motivet e mira për të studiuar Biblën (Gjo. 5:39)?

9. Çfarë mendon? Veço pohimet që pasqyrojnë më mirë bindjet e tua mbi Biblën, duke shënuar me √ germën e alfabetit që e paraprin:

a. Besoj që Bibla është Fjala e Perëndisë drejtuar njeriut, është shkruar nga njerëz të ndryshëm në harkun e

shumë viteve, është pa gabime në shkrimet e saj origjinale, është e saktë e besueshme si në faktet historike dhe në doktrinën e shprehur nga ajo vetë.

b. Besoj që vetëm fjalët e Jezusit në Bibël janë të frymëzuara.

c. Besoj që shumë tregime të Biblës, si ai i Adamit dhe Evës, Noeu dhe arka nuk duhet të merren në kuptimin e vërtetë të fjalës, megjithatë na mësojnë diçka.

d. Besoj që Bibla ka shumë kontradikta.

e. Besoj që Bibla përmban atë që duhet të di mbi Perëndinë mbi jetën e tanishme dhe të ardhmen.

f. Besoj që Bibla ka shumë mësim të mira mbi moralin, por nuk është e vërteta absolute.

g. E vërteta e Biblës është e vlefshme për të gjithë brezat, të gjithë kulturat, të gjithë racat.

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre këto pyetje:

(1) Po të jesh ti Perëndia dhe ke dëshirë komunikosh me njerëzit, si do të veprësh?

(2) Çfarë prove ke nevojë ti që të jesh i bindur që Bibla është Fjala e Perëndisë, mesazhi i Perëndisë?

(3) Nëse dikush të provon që Bibla është e vërtetë, a do jesh i gatshëm t'u bindesh mësimëve të moralshme që ndodhen në të?

## PERSONI I PERËNDISË

«UNË JAM PERËNDIA DHE NUK KA ASNJË TJETËR; Unë jam Perëndia dhe asnjë nuk është i ngjashëm me mua» (Isa. 46:9). Bibla flet për të vetmen Qenie Supreme. «Te Lartit, qiellorit, që banon në përjetësi» (Isa. 57:15). Përtej misterit dhe të pafundësisë së qenies së tij absolute, Ai na është paraqitur si «Perëndia i gjallë» (Psalmi 42:2; 84:2; Danieli 6:20; 1 Tim. 4:10; 6:17; Heb. 9:14; 10:31). «Madhështia e Tij nuk mund të matet» (Psalmi 145:3). Madhështia e Tij është e tillë sa «tek ai jetojmë, lëvizim, dhe jemi» (Veprat 17:28). Vazhdimisht vihet re kjo shprehje: «O Perëndi kush është i barabartë me ty?» (Psalmi 71:19; 89:9; 113:5). Përgjigjja nuk mund të jetë veçse kjo: «Nuk është asnjë i barabartë me ty».

### Besime popullore mbi Perëndinë

Emri «Perëndi» gjithmonë ka qenë në buzët e shumë vetëve. Kanë qenë ata që e kanë mohuar ekzistencën e Tij, ata që e kanë përdorur emrin e tij për mallkime dha ata që e kanë ngatërruar dhe paraqitur gabimisht çfarë Ai është. Ateistët thonë që Perëndia nuk ekziston dhe mund ta provojnë. Agnosticistët thonë që është e pamundur të njohësh ekzistencën e Tij dhe bëjnë shumë për t'i çuar turmat të bashkohen me ta në një deklaratë injorancë. Panteistët thonë që Perëndia është vetëm natyrë dhe kjo është vetëkrijuar dhe që njeriu është pjesë e saj. Politeistët nga ana tjetër thonë që nuk ekziston vetëm një perëndi por shumë; Vihet re në radhët e tyre një shumëllojshmëri e madhe nga paganët deri tek mormonët e sotëm. Por disa ide të ndryshme kanë shkuar më tej. Është thënë që çdo gjë është Perëndi, ti dhe unë të përfshirë, ose që Perëndia është një parim, një ligj apo forcë pa personalitet. Është theksuar përsëri që Perëndia është thjesht një ide e mendjes njerëzore, një mbështetje psikologjike apo një frikë e paarsyeshme. Njerëzit kanë krijuar imazhe apo idhuj me qëllim që të paraqesin perënditë (Veprat 19:23-28) megjithëse në Bibël një gjë e tillë është e ndaluar (Eksodi 20:4-5). Shumë shpesh ata janë vetëquajtur Perëndi dhe i kanë shtyrë të tjerët që t'i adhurojnë. Ata që refuzojnë të pranojnë përgjegjësinë që kanë ndaj një Qenie Supreme, në realitet, bëjnë perëndi veten e tyre.

### Autoprova e Perëndisë

Bibla nuk kërkon të provojë ekzistencën e Perëndisë, ajo merr parasysht që kjo njihje është rrënjësore në thellësitë më të mëdha të qenies dhe të ndërjegjes së njeriut. Ajo thotë që i marri mohon ekzistencën e Tij (Psalmi 14:1; 53:1). Në përgjithësi, në arkeologji, konsiderohet si provë e pranisë së njeriut, evidenca e adhurimit të Perëndisë. Asnjë diktaturë nuk ka qenë në gjendje të shkatërrojë besimin tek Perëndia, me gjithë sforcimet e mëdha të bëra. Pjesa më e madhe e historisë tregon që njeriu ka qenë gjithmonë thellësisht i bindur për ekzistencën e Perëndisë dhe që Atij do t'i japë llogari. Kjo vetëdije është themeli i përgjegjësisë së tij ndaj Perëndisë «Në të vërtetë, ajo që njerëzit mund të dinë për Perëndinë, u është bërë e njohur. Perëndia ua ka zbuluar vetë. Askush, vërtet, nuk mund ta shohë Perëndinë; por ai u zbulohet njerëzve me anë të veprave të tij. Meqë ka krijuar botën, ata mund ta njohin fuqinë e tij të përjetshme, ashtu edhe qenësinë e tij hyjnore, n.q.s. duan të dinë për këtë çështje. Prandaj nuk kanë asnjë përligje (për mosbesim)». (Romakëve 1:19-20). Bindja e qëndrueshme për ekzistencën e Perëndisë ishte e pranishme shumë kohë më parë se sa njerëzit të vendosnin së bashku argumente në favor ose kundër një besimi të tillë. Sulmet sistematike nga ana e Shtetit, e sistemi edukativ dhe mjeteve të informimit në masë janë drejtuar të gjitha për të dobësuar besimin tek Perëndia. Si rezultat, është e dukshme që si krenaria, arroganca intelektuale, mbrapshtia dhe degjenerimi shoqëror rriten, rriten edhe pikëpyetjet mbi ekzistencën e Perëndisë. Në fakt disa pyesin, «Përse duhet të besojmë tek Perëndia? Mundemi të shpjegojmë çdo gjë mbi një bazë natyraliste ose evolucioniste!» Ata të cilët e mbajnë veten se janë më të zgjuar se ata që besojnë tek Perëndia duhet të konsiderojnë që:

1. ASNJË GJË NUK E KA FILLIMIN NGA VETJA. Asnjë studim shkencor nuk ka treguar që ekziston një zinxhir pa fund duke filluar nga asgjë. Në fakt, asgjë del nga asgjëja. Bibla thotë: «çdo gjë ndërtohet nga dikush; por Perëndia ka ndërtuar gjithçka» (Heb. 3:4).



2. STRUKTURA TE PËRPUNUARA KËRKOJNË NJË KONSTRUKTOR OSE NJË PROJEKTUES. Pjesët më të rëndësishme të një njeriu, si p.sh.: truri ose sytë, janë më të komplikuar se një përpunues të dhënash ose se një orë. Askush nuk beson që kjo e fundit të jetë formuar rastësisht. Dhe aq më pak një sy!

### VIZIONI BIBLIK I PERËNDISË

1. ËSHTË VETËM NJË PERËNDI. Qoftë Dhiata e Vjetër dhe qoftë Dhiata e Re pohojnë që është një Perëndi i vetëm (LiP. 6:4; Isa. 45:5; 1 Tim.2:5). Judaizmi dhe islamizmi puqen në këtë me besimin e krishterë. Shumë njerëz flasin për perëndi të tjerë (1 Kor. 8:5,6) dhe Bibla e përdor shpesh termin me një domethënie inferiore (Eksodi 7:1; Psalmi 82:6), por është vetëm një Perëndi unik i vërtetë.

2. PERËNDIA EKZISTON NË TRE PERSONA. Perëndia i vetëm është një njësi «shumës», Ai është një në thelb, por i zbuluar në Shkrimin e Shenjtë si shumë në dallimin e personalitetit. Një emër i Perëndisë në Dhiatën e Vjetër është **Elohim** i përdorur rreth 2600 herë. Ky emër është shumë në formë megjithëse përdoret disa herë me një folje njëjës. LiP 6:4 është pohimi tipik hebraik sipas së cilit është vetëm një Perëndi. «I Përjetshmi, Perëndia ynë, është I Përjetshmi i vetëm». Ky varg përdor **Elohim**. Vërejmë, gjithashtu, që Perëndia flet shpesh për veten, gjithmonë në Dhiatën e Vjetër, duke përdorur «ne» (Zanafilla 1:26; 3:22). Asnjë mbret i Izraelit nuk ka folur me këto terma për veten e tij asnjëherë. Ka pastaj referime që tregojnë një dallim ndaj «Perëndisë dhe Perëndisë» (Psalmi 45:6,7; Heb. 1:8, ose «I Përjetshmi i tha Zotit tim», Psalmi 110:1, Mateu 22:42-46). Zbulimi i plotë i ekzistencës së Perëndisë si At, Bir dhe Fryma e Shenjtë na jepet në Dhiatën e Re, secili prej tyre quhet qartë Perëndi, edhe pse Dhiata e Re pohon qartësisht që është vetëm një Perëndi.

a. Ati është Perëndi. Shiko 1 Thes. 1:1; 2 Pje 1:17.

b. Fryma e Shenjtë është Perëndi. Shiko Veprat 5:3-4; 2 Kor. 3:17.

c. Biri është Perëndi. Shiko 1 Gjo. 5:20; Titi 2:13; Gjo. 1:1,14; 20:26-28; Romak. 9:5; Kol. 2:8-9; 1 Tim. 3:16; Heb. 1:8; Zbu. 1:8,17-18.

Të gjitha atributet hyjnore i janë atribuar secilit; gjithashtu cilësi si vullneti, emocionet dhe arsyeja. At, Bir dhe Fryma e Shenjtë dallohen nga njëri-tjetri e megjithatë janë të bashkuar në një shoqate hyjnore (1 Pje. 1:2; Juda 20-21). Emrat e tyre janë bashkuar në formulën e pagëzimit (Mt. 28:19) edhe në bekimin apostolik (2 Kor. 13:14). Mund të identifikohen në pagëzimin e Jezusit (Mt. 3:16-17) dhe në diskutimin e tij i sjellë tek Gjoni (Gjo. 14:16-20; 15:26; 16:7-16). Uniteti vërtetohet (Gjo. 14:9; 17:22). Megjithëse quhen «personat e Perëndisë», ata ndryshojnë nga ajo që ne kuptojmë për «persona». Nuk flitet për tre perëndi të ndryshëm, as për një perëndi me tre kokë; në thelb nuk flitet për gjë tjetër vetëm për një Perëndi të vetëm. Fjala «Trini» përdoret për të përshkruar në mënyrë të përshtatshme Perëndinë megjithëse ajo nuk është në Bibël; kjo vlen edhe për shprehjen «Perëndia trini». Nga momenti që nuk kemi asgjë për ta krahasuar me Perëndinë nga ky këndvështrim, nuk kemi asnjë term në gjuhën tonë që të shprehë plotësisht këtë të vërtetë. Bibla nuk e shpjegon; dhe neve nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të pranojmë pohimet drejtpërdrejta të Shkrimit, pa i diskutuar.

3. PERËNDIA ËSHTË SHPIRT. Shiko Gjo 4:24. Ai mund të marrë tipare njerëzore ose të dëgjohet nëpërmjet një zëri; mund të manifestohet, gjithashtu në ndonjë manifestim natyror si bubullimë ose vetëtimë. Përveç këtyre, Perëndia është një qenie shpirtërore e padukshme që nuk mund të lidhet nga hapësira, nga koha ose nga materia.

4. PERËNDIA KA PERSONALITET. Ai nuk është një parim i thjeshtë ose ide. I janë vënë karakteristika personale, si njohja (1 Gjo. 3:20), ndjeshmëria ose emocionet (Zanafilla 6:6), vullneti ose aftësia për të vendosur (Jakobi 1:18). Ai manifeston qoftë dashuri qoftë zemërim; kujton ose vendos të harrojë; bën ligje dhe shpall të ardhmen. Perëndia nuk është një makinë vetë funksionale. Është ngushëllim i madh për besimtarin të dijë që Perëndia është dashuri (1 Gjo. 4:8-16). Asnjë parim nuk do të justifikonte pohimin e 1 Pje. 5:7, «hidhni mbi të të gjitha shqetësimet tuaja, sepse Ai kujdeset për ju».

Fjala angleze «God» (Perëndi) rrjedh nga «good» (i mirë). Perëndia në fakt është i mirë. Ai është quajtur

edhe Zoti, i Plotfuqishmi, Krijuesi, Shpëtimtari, Çliruesi dhe në shumë mënyra të tjera. Emri Jehovah rrjedh nga **JHVH**, një fjalë me katër shkronja që tregon Emrin Hyjnor në Dhiatën e Vjetër. Ai nuk shqiptohet asnjëherë dhe mund të bëjmë vetëm supozime mbi se cila ka qenë drejtshkrimi i saj i plotë dhe shqiptimi i saktë. Askush nuk mund të pohojë biblikisht që ekziston një emër i vetëm i pranueshëm për Perëndinë. Përkundrazi, është e rëndësishme të njohësh Perëndinë e Biblës, ai i cili na urdhëron të dëgjojmë Birin e tij Jezu Krishtin. Dhe në fakt, Ai është rruga e vetme për të arritur tek Perëndia (Gjo. 14:6).

## Pyetje - Mësimi 2

Është e rëndësishme të dish se tek kush besojmë dhe është e rëndësishme ta njohësh atë person. Kujt i ngjan Perëndia? Ke ide të gabuara mbi Të?

1. Perëndia është (zgjidh një përgjigje)

- a. një ide
- b. një forcë
- c. një njeri
- d. frymë

2. Cila nga pohimet e mëposhtme përshkruam më mirë konceptimin tënd për Perëndinë?

- a. polic
- b. menaxher
- c. babai yt në tokë
- d. një makinë
- e. asnjëra prej përgjigjeve të mësipërme

3. Si do t'ia përshkruaje Perëndinë ndonjërit që nuk ka dëgjuar asnjëherë të flitet për Të?

4. A kërkon Bibla të provojë ekzistencën e Perëndisë? Apo a supozon Bibla që ekzistenca e Perëndisë është tashmë për vetveten një provë (Zanafilla 1:1)?

Si mund të dijë për ekzistencën e Perëndisë një person që nuk ka dëgjuar asnjëherë të flitet për Biblën (Psa. 19:1-4; Rom. 1:19-20)?

Përse beson që Perëndia ekziston?

5. Bibla mëson që (zgjidh një përgjigje)

- a. është një Perëndi i vetëm
- b. janë tre perëndi
- c. janë shumë perëndi
- d. të gjithë adhurojmë të njëjtin Perëndi

6. Në çfarë mënyre i konsideron Bibla «perënditë» e tjera që njerëzit i adhurojnë (1 Kor. 8:5-6)? Shkruaj me fjalët e tua këtë argument.

7. Si do t'ia shpjegoje ndonjërit këtë që vijon: Ati është Perëndi. Biri është Perëndi. Fryma është Perëndi. Ekziston

një Perëndi i vetëm.

8. Perëndia është shpirt do të thotë (zgjidh një përgjigje)

- a. Perëndinë ne nuk mund ta njohim
- b. Perëndia nuk mund të shihet
- c. Perëndia nuk mund të zbulohet në mënyrë të dukshme
- d. Perëndia nuk është personal

9. Çfarë mendon? N.q.s. Perëndia është një person, është e mundur të kesh një raport personal me Të. Si do ta përshkruaje raportin tënd aktual me Të?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë javës dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

- (1) Si do ta përcaktoje Perëndinë?
- (2) Sipas jush, cila është prova më e rëndësishme e ekzistencës së Perëndisë (n.q.s. personi nuk beson tek Perëndia pyete përse nuk beson)?
- (3) N.q.s. mund t'i kërkoje Perëndisë ndonjë gjë, çfarë do t'i kërkoje?

## PËRNGJASIMI I PERËNDISË

«KUJT DËSHIRON T'I PËRNGJAJË PERËNDIA?, dhe çfarë figure do t'i vinit përballë?», pyeste profeti (Isa. 40:18). Bibla thekson që Ai nuk i ngjason saktësisht ndonjë gjëje ose ndonjërit që njohim ne; ajo përdor gjuhën tonë për ta përshkruar me terma njerëzore. Fakti që Bibla flet shpesh për krahun, syrin, dorën apo gojën e Zotit, nuk do të thotë që Ai i zotëron vërtet këto organe, dhe aq më pak që Perëndia i ngjan një zogu kur në Bibël lexohet «Ai do të të mbulojë me pendët e tij» (Psalmi 91:4). N.q.s. Perëndia do të kuptohej plotësisht, shpjegohej dhe analizohet nga njeriu, kjo do të thoshte që Ai ekziston në nivelin njerëzor. Duhet të kemi kujdes që të mos refuzojmë Perëndinë vetëm sepse nuk kemi një pikë referimi apo një eksperiencë për ta vënë përpara. Një njeri pyeti Jobin: «A mundesh ti...të arrish të njohësh plotësisht të Plotfuqishmin?» (Jobi 11:7). Përgjigjja është që ne mund të dimë mbi Perëndinë vetëm atë që Ai ka dashur të na zbulojë për Vetën e Tij në Shkrim, asgjë më shumë. Disa koncepte, në fakt, i tejkalojnë kufizimet e aftësisë sonë mendore.

### Atribute të vetme (që vetëm Perëndia i zotëron)

Jepen në Shkrim disa pohime mbi cilësitë e Perëndisë dhe kjo bëhet pikërisht sepse Ai ka zgjedhur që t'i zbulojë. Ne i quajmë «tribute». Perëndia është:

1. **EKZISTON NGA VETVETJA.** Ai ka jetë në veten e Tij (Gjo. 5:26); nuk vjen nga asnjë gjë tjetër që ka ekzistuar më parë. Perëndia ekzistonte tashmë që nga fillimi (Zan. 1:1; Gjo. 1:1).
2. **I PËRJETSHËM.** Nga «përjetësia në përjetësi» Ai është Perëndi (Psalmi 90:2; Habakuku 1:12). «Ai që është» shpreh emrin e UNË JAM-it (Eksodi 3:14); Atij që kupton në vetvete të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen (Zbu. 4:8).
3. **I PAFUND.** ky term do të thotë «pa kufizim ose pa limit». Asgjë nuk mund ta nxërë Perëndinë (1 Mbretit 8:27), asgjë nuk mund ta masë.
4. **I PLOTFUQISHËM.** I Plotfuqishmi ka fuqinë dhe autoritetin të bëjë gjithçka që i pëlqen (Jobi 42:2; Mt. 19:26). Kjo përcaktohet si «plotfuqishmëri».
5. **I GJITHËDITSHËM.** Perëndia ka njohje, zgjuarsia dhe vetëdije të pakufizuar (Psalmi 147:4-7). Asgjë nuk mund ta kufizojë në ndonjë farë mënyre në këtë dhe asgjë nuk mund ta çudisë ose ta mashtrojë (Heb. 4:13; 1 Gjo. 3:20). Kjo përcaktohet si «gjithëditshmëri». Që në fillim Perëndia njeh fundin (Isa. 46:10). Gjithëditshmëria përfshin edhe paranjohjen e të gjitha gjërave (Veprat 2:23).
6. **I GJITHËPRANISHËM.** Perëndia nuk është i kufizuar as nga hapësira as nga koha; Ai është gjithandej në të njëjtin moment (Psalmi 139:7-12). Kjo cilësi quhet «gjithëpranishmëri». Nuk ka mënyrë për t'iu shmangur (Jeremia 23:23-24; Amosi 9:2).
7. **I PANDRYSHUESHËM.** Mund të ndryshojë në veprimet dhe në mënyrën e të vepruarit, por Perëndia nuk ndryshon në karakterin e tij të përjetshëm dhe në qëllimet e tij (Malakia 3:6; Jakobi 1:7). Është gjithmonë konstant dhe besnik. Kjo cilësi quhet «pandryshueshmëri».
8. **I VETËMJAFTUESHËM.** Nuk ka nevojë absolutisht për asgjë sepse tek Ai nuk ka mangësi (Veprat 17:24-25).
9. **SOVRAN.** Ai qeveris dhe kontrollon të gjitha gjërat dhe askush nuk mund ta pengojë; lëviz të gjitha gjërat sipas këshillës së vullnetit të Tij (Efes. 1:11; Isa. 40:13-14). Si Perëndi, Ai ka të drejtën e pakufizuar të bëjë çfarëdo që i pëlqen Atij ta bëjë (Rom. 9:15-18). Ai nuk i ka borxh askujt.

## **Atribute relative (që edhe njeriu mund t'i ketë)**

1. **DASHURI.** Është shprehja e sakrificës dhe e dhurimit të vetes, ajo në fakt kërkon të mirën maksimale të tjetrit. Është praktike dhe e dobishme. Meqë Perëndia na ka dashur, ka dhënë Birin e Tij për të vdekur për ne (Gjo. 3:16). Ai do pavarësisht nga gatishmëria e njeriut për ta shkëmbyer këtë dashuri, që është (njeriu) objekti i dashurisë së Tij. Në fakt Perëndia do personin kundërshtar, të përçmuar dhe plot me mëkat, megjithëse Ai e urren mëkatin (1 Gjo.. 4:10; Efes. 2:4-5; Rom. 5:8; Jeremia 31:3). Dhembshuria është e lidhur ngushtë me dashurinë; përmbledh pjesëmarrjen intime në ndjenjat e tjetrit, mëshirën për të tjerët (Ps. 86:15; Mt. 9:26; 14:14).
2. **ZEMËRIMI.** Zemërimi i tij i shenjtë kundër së keqes nga e cila njerëzit nuk heqin dorë dhe për të cilën nuk do të pendohen (Kol. 3:5-7; Rom. 2:4-6), nuk është një borxh që mund ta shlyesh me vepra të mira (Rom. 4:4-5; 11:6). Hiri i ofron shpëtim njerëzimit (Efes. 2:8; Titi 2:11).
3. **MËSHIRA.** Mëshira e tij e madhe, ose dhembshuria drejt mëkatarëve dhe nevojtarëve, atje ku lehtësim jepet, është e njëjtë me hirin (Psa. 103:8). Perëndia është i pasur në mëshirë (Efes. 2:4).
4. **SHENJTËRIA.** Perëndia është veçuar nga qeniet e tjera dhe nuk ka mëkat ose ndonjë papastërti tek Ai (Ps. 99:9; Isa. 57:17). Ai është quajtur «I Shenjti». Qielli lartëson shenjtërinë e Tij (Zbu. 15:4; Heb. 7:26). Kjo cilësi kërkon domosdoshmërisht ndëshkimin e mëkatis (Isa. 59:2). Jemi thirrur të jemi të shenjtë sepse Ai është i shenjtë (1 Pje. 1:16).
5. **NDERSHMËRI DHE DREJTËSI.** Këto dy fjalë rrjedhin nga e njëjta rrënjë, në gjuhën origjinale të Dhiatës së Re. Duan të tregojnë që të dyja paanshmëri ose paanësi në trajtimin e të tjerëve. Asgjë e gabuar nuk mund të vijë nga Perëndia (Nehemia 9:33; Ps. 145:17). Ai është gjykatësi i Drejtë (2 Tim. 4:8) dhe do të bëjë patjetër atë që është e drejtë (Zan. 18:25); drejtësia e Tij kërkon pagim për ndëshkimin e mëkatis, por dashuria e Tij parashikon për pagimin kështu që Ai mund të jetë në të njëjtën kohë «i drejtë dhe shfajësues për atë që beson tek Jezusi» (Rom. 3:26).
6. **E VËRTETA.** Tek Perëndia nuk ka pavërtetësi, as pabesi, as mungesë koherence (Numrat 23:19; 1 Gjo. 5:20). Ai është e vërteta (Gjo. 14:6). Ai është besnik në gjithçka dhe për të gjitha dhe në mënyrë absolute (2 Tim. 2:13; Zbu. 19:11).
7. **DURIMI.** Vetvendosja e Tij për të kufizuar veprimet, që ndryshe mund edhe të zbatoheshin fare mirë, është një cilësi që i dedikohet atij që zotëron një fuqi të madhe. Durimi për të duruar atë që është e papëlqyeshme, është një aspekt (Rom. 9:22; Veprat 13:18); tjetri është këmbëngulja për të rigjetur të mirën (2 Pje. 3:9).
8. **DITURI.** Perëndia zotëron të gjithë njohjen dhe aplikimin e saj dhe kjo tregon nga ana e Tij një dituri të pafund, një zgjuarsia të lartë e bashkuar me një gjykim të pakrahasueshëm (Rom. 11:33; Efes. 3:10). «Zgjuarsia e tij është e panjohshme» (Isa. 40:28). Ky Perëndi me dituri shumë të lartë ekzaminon në thellësi zemrat e të gjithë njerëzve (Rom. 8:27; 16:27).
9. **DASHAMIRËSI.** Dashamirësia e Tij është pikërisht cilësia që udhëheq njeriun në pendim (Rom. 2:4). Perëndia është i mbushur plot me këtë dashamirësi, vullnet të mirë ose mirëdashje (Ps. 119:68; 145:9). Vështirësitë dhe hidhërimet njerëzore nuk duhet të na çojnë që të dyshojmë për dashamirësinë e Tij.
10. **ZEMËRGJERËSI.** Perëndia është më i madhi i të gjithë dhuruesve dhe e ka treguar në dhuratën supreme të Birit të Tij (Gjo. 3:16). Është kjo arsyeja për të cilën Ai do një dhurues të gëzuar (2 Kor. 9:7). Perëndia jep me zemërgjerësi (Jak. 1:5). Është Ai që hap qiellin për të dërguar poshtë bekimet me bollëk. Ai është i vetmi që jep

në atë masë «sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini» (Malakia 3:10).

### Pyetje - Mësimi 3

Mënyra e të vepruarit e Perëndisë qeveriset nga karakteri i Tij dhe nga atributet e Tij. Pyetjet e mëposhtme do të na ndihmojnë për ta kuptuar më mirë.

1. Është e vështirë për njeriun për ta kuptuar se kujt i përngjan Perëndia sepse (zgjdh një përgjigje)
  - a. njeriu beson që Perëndia i përngjan atij
  - b. rrugët e Perëndisë janë «më të larta» se ato të njeriut
  - c. nuk ka asgjë ose asnjë me të cilin mund të krahasohet Perëndia
  - d. Perëndia nuk mund të njihet
  - e. për gjithçka që u tha më lart
  - f. nga përgjigjja a deri tek përgjigjja c
2. Çfarë relacioni ka Perëndia me gjithçka që ekziston (Veprat 17:24-25)?

Çfarë cilësi të Perëndisë janë përshkruar në vargjet që pasojnë, të cilët nxjerrin në pah pavarësinë e Tij të plotë?  
(Shpjego me fjalët e tua)

Gjo. 5:26; 1:1

Zanafilla 1:1

Eksodi 3:14

Ps. 90:2

Zbu. 4:8

1 Mbret. 8:27

3. Lexo Psalmin 139. Shkruaj tre cilësi për sa i përket Perëndisë, që tregohen në këtë pjesë.
  - a.
  - b.
  - c.

4. Shkruaj me fjalët e tua (Rom. 8:28).

Çfarë inkurajimi mund të marrë një besimtar nga kjo pjesë?

5. Cili nga pohimet e mëposhtme mbi dashurinë e Perëndisë nuk është i vërtetë?
  - a. Perëndia e do të gjithë botën
  - b. Perëndia na ka dashur më parë se ne ta donim

- c. Dashuria e Perëndisë është e përjetshme
- d. Dashuria e Perëndisë e toleron mëkatin

6. Zemërimi i Perëndisë është real aq sa dhe dashuria e Tij. Kush ose çfarë gjëje është objekt i zemërimit të Perëndisë? (Zgjidh tre përgjigje)

- a. e gjithë mbrapshtia dhe padrejtësia e njerëzve
- b. zemra e ngurtësuar dhe e pandreqshme
- c. kush nuk i bindet
- d. mëkatari i falur

7. Çiftëzo cilësitë e mëposhtme të Perëndisë me përkufizimet e dhëna nga e majta:

- |  |   |
|--|---|
| -Favor drejt të tjerëve i pamërituar dhe i dhënë falas                           | a. Hiri (Efes. 2:8; Titi 2:11)                    |
| -Mëshirë e madhe ose dhembshuri drejt mëkatarëve dhe nevojtarëve.                | b. Shenjtëria (Zbu. 15:4; Ps. 99:9)               |
| -Plotësisht i privuar nga papastërtitë ose mëkatit. I veçuar nga qeniet e tjera. | c. Mëshira (Ps. 103:8; Efes. 2:4)                 |
| -Paanshmëri në trajtimin e të tjerëve.   | d. Ndershmëri/Drejtësi (Nehemia 9:33; Zan. 18:25) |

8. Kur Bibla thotë që Perëndia është i shenjtë, do të thotë që (zgjidh një përgjigje)

- a. është pa mëkat
- b. urren mëkatin dhe do gjithçka që është e mirë
- c. është i ndarë nga mëkatarët
- d. të gjitha përgjigjet e lartpërmendura

9. Çfarë mendon? Reflekto me kujdes mbi cilësitë e Perëndisë të studiuara më lart. Cilat të ngushëllojnë dhe të inkurajojnë në mënyrë të veçantë?

Ka të tjera që të shqetësojnë? (N.q.s. «po» ose «jo», shpjego arsyen).

Shpesh njerëzit thonë: «Jam i bindur që Perëndia do të bënte këtë gjë» ose «nuk mendoj që Perëndia do të bënte këtë gjë». Përse është e rëndësishme të kuptosh karakterin e Perëndisë përpara se të spekulosh mbi atë që mund të bënte ose nuk mund të bënte Ai?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre vetë gjatë kësaj jave dhe bëji atyre këto pyetje:

- (1) Cilat janë, sipas jush, cilësitë e Perëndisë që i zotëron vetëm Ai?
- (2) Çfarë do të thotë që Perëndia është i shenjtë?
- (3) Si e shpjegoni përshkrimin biblik për Perëndinë, sipas së cilës Ai është një Perëndi i dashurisë dhe një Perëndi i zemërimit?

## TË KUPTOSH NJERIUN

«**ÇFARË ËSHTË NJERIU QË TA MBASH MEND?**», pyeste psalmisti (Ps. 8:4). Trupat tanë vijnë nga pluhuri dhe në pluhur do të kthehen (Zan. 3:19). Çfarë jemi ne? Përse jemi të rëndësishëm? Cili është qëllimi i ekzistencës sonë? Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve do të influencojë thellësisht në mënyrën tonë të të shikuarit të gjërave dhe në mënyrën tonë të të jetuarit.

### Zanafilla e njeriut

Shumë kanë pohuar që njeriu është thjesht një ndër shumë nga format e jetës që lindën në univers rastësisht. Ata thonë që njeriu nuk është gjë tjetër veçse një «kafshë fisnike», «kulmi i evolucionit»; ka një jetë kalimtare, që nuk ka ndonjë domethënie të veçantë që të zgjasë në kohë. Shumë njerëz, duke treguar që e aprovojnë këtë teori, jetojnë thjeshtë si kafshë, duke kapur në mënyrë egoiste të gjitha kënaqësitë që janë në dispozicion, duke jetuar në dëshpërim dhe duke pritur që të zhduken në hiç. Ndërsa disa të tjerë zotërojnë një koncept të përzier për jetën, sipas së cilës ajo është një lloj rrote kozmike që rrotullohet vazhdimisht. Këta pohojnë që jeta gjithmonë ka ekzistuar në një farë lloji. Njeriu shfaqet, vdes, gllabërohet nga shorti i «hiçit» dhe pastaj «rimishërohet» në ndonjë formë tjetër jete. Nuk jepet as këtu ndonjë shpjegim që të tregojë ndonjë gjë në këtë drejtim, asnjë referim për një Perëndi personal. Ballafaqo këto dy sisteme besimesh. Cili rezulton më i logjikshëm?

#### Besimi në zanafillën e rastësishme

1. Në fillim nuk ekzistonte asgjë. Materia, ose energjia, erdhi në dritë pa arsye, duke formuar më pas sisteme planetare të plota plotësisht rastësisht.

2. Jeta pati fillim spontan në sisteme të ndryshme planetare. U zhvillua gradualisht nga format e thjeshta deri tek ato më të komplikuar, duke mos ndjekur asnjë rregull të veçantë. Prapa saj nuk kishte asnjë zgjuars, asnjë arkitekt.

3. Njeriu u evolua nga të parët e lashtë të njëjtë me majmunët. Është një kafshë pa asnjë natyrë shpirtërore, një aksident biologjik i hapësirës, pa qëllim dhe pa të ardhme.

#### Besimi në Krijuesin Suprem

1. Perëndia ka krijuar gjithësinë, duke përfshirë edhe tokën, njeriun, kafshët tokësore dhe ato ujore, zogjtë dhe krijesat e tjera (Zan. 1:1-2:25; Gjo. 1:3; Kol. 1:16; Heb. 11:3).

2. Perëndia, Zgjuarsia Supreme, është autori i projektit, i rregullave dhe ligjeve të universit. Është burimi i të gjitha formave të jetës. Njeriu është krijimi i tij më i lartë, i bërë sipas shëmbëlltyrës dhe me ngjashmëri shpirtërore.

3. I gjithë njerëzimi rrjedh nga qenie njerëzore origjinal të krijuara nga Perëndia, siç përshkruhet tek Zan. 1-2. Njerëzit dallohen nga kafshët nga aftësia e tyre për të njohur shpirtërisht Perëndinë dhe ta adhurojnë, për të patur një gjuhë të rregullt dhe një komunikim me shkrim një shpirt që nuk do të mbarojë asnjëherë së ekzistuarit.

Bibla thotë: «Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën...Perëndia krijoi njeriun» (Zan. 1:1,27). «Ai na ka bërë dhe jo ne vetë» (Ps. 100:3). Perëndia na njihete përpara se të lindnim (Ps. 139:13-16). Përse na ka krijuar? Për kënaqësinë e tij (Kol. 1:16; Zbu. 4:11). Ai ishte poçari dhe ne argjila (Rom. 9:20-21). Cili është pra qëllimi ynë mbi tokë? Jemi krijuar për të lavdëruar Perëndinë (Rom. 1:21; Ps. 86:9,12; Mt. 5:16). Megjithëkëtë, njeriu ka refuzuar që të adhurojë dhe t'i shërbejë Krijuesit të tij (Rom. 1:25); në fakt ka dëshiruar të jetojë për veten e tij.

### Natyra e njeriut

Njeriu është krijuar sipas shëmbëllimit dhe në ngjasim me Perëndinë (Zan. 1:26; 5:1; 9:6). Domethënia është «hije» ose «ngjashmëri». Meqë Perëndia është shpirt, ngjashmëria nuk është fizike por shpirtërore (Efes.



4:24; Kol. 3:10). Ky është aspekti kryesor i të qenies unike të njeriut. Njeriu është i formuar nga një pjesë materiale i quajtur trup, për shumë pikëpamje, i ngjajnë trupave të krijesa të tjera për funksionet e tyre jetësore. Megjithatë, ai është vetëm «tenda» ose «shtëpia tokësore» në të cilin ai jeton (2 Kor. 5:1-4; 2 Pje. 1:13-14). Në mënyrën më domethënëse, njeriu ka një frymë dhe një shpirt, duke formuar së bashku me trupin qenien e tij të trefishtë (1 Thes. 5:23). Është e vështirë ta dallosh frymën nga shpirti (Heb. 4:12). Trupi ka një kontakt të ndjeshëm me atë që e rrethon; prandaj detyra e tij është që të jetë i vetëdijshëm për botën e jashtme. Shpirti është qendra e emocioneve, e arsyes dhe e vullnetit (Ps. 13:2; 42:5). Është qendra e vetëdërgjegjes. Fryma ka të bëjë me aftësinë tonë për të njohur Perëndinë dhe gjërat që i përkasin sferës shpirtërore. Është selia e ndërgjegjes së Perëndisë (Rom. 8:16). Edhe ai që nuk e njeh Perëndinë e ka frymën (Jakobi 2:26).

Pjesa intime e njeriut shpesh quhet «zemër» (LiP. 29:4; Ps. 40:8,10,12; Fja. 14:10; Isa. 44:18); dëshirat, perceptimet dhe sjelljet e brendshme konsiderohen që vijnë nga ky burim i vetëm. Ndërgjegjja, siç e dimë të gjithë, është e ndjeshme ndaj asaj që është e drejtë ose e gabuar, drejt së mirës ose së keqes (Rom. 2:15; Heb. 5:14). Ajo i flet vetëdijes sonë për detyrën ose për përgjegjësitë, siç i flet edhe vetëdijes sonë morale. Në fakt shpesh themi, «lëre të të udhëheqë ndërgjegjja jote». Pa dyshim është gjë e urtë të dëgjosh gjithmonë ndërgjegjen tënde, megjithëse e dobët dhe shumë e ndjeshme (1 Kor. 8:10). Megjithatë, një ndërgjegje mund të jetë e mirë (Vep. 23:1; 1 Tim. 1:5,19; Heb. 13:18) ose e keqe (1 Tim. 4:2; Heb. 10:22), e pastër (1 Tim. 3:9; 2 Tim. 1:3) ose e përdhosur (Tit 1:15). Ajo duhet të mbahet e pastër (Veprat 24:16).

### Zgjedhja e njeriut

Të vendosh për diçka, të nxjerrësh në lojë zgjedhjet e tua, veçanërisht në fushën morale dhe në atë shpirtërore, është detyra më e rëndësishme e ndërgjegjes së njeriut. Këto vendime mund të influencojnë fatin tonë të përgjithshëm. Perëndia shumë qartë ia ka dhënë njeriut të drejtën të zgjedhë dhe e ka bërë bazë për vendimet e drejta (LiP. 30:15,19; Jozue 24:15; Zbu. 20:12-13). Njeriu i pëlqen të zgjedhë, por nuk i pëlqen të paguajë pasojat e zgjedhjeve të gabuara. Ai akuzon Perëndinë, mënyrë për të ulur përgjegjësitë e tij, duke vazhduar duke bërë zgjedhje të këqija. Disa sisteme fetare mësojnë që njeriu është një robot moral i projektuar nga Perëndia, i cili vendos gjithçka, duke mos formuar asnjë rast real për të zgjedhur. Nuk ka arsye për një mësim të tillë; Perëndia thërret njeriun të zgjedhë dhe thotë n.q.s. ata largohen nga Ai janë pa justifikim (Rom. 1:20).

### Rënia e njeriut

Njerëz reflektues, gjatë mijëra vjetëve, kanë pasur mundësi që të kuptojnë që në diçka njeriu ka gabuar. Edhe disa lloje kafshësh tregojnë aftësinë për të jetuar në harmoni dhe bashkëpunim me individët e llojit të tyre. Por përse njeriu vret, urren, sillet në mënyrë brutale, i lë të tjerët të vuajnë urie dhe të vdesin? Përse egoizmi dhe sjellja e keqe janë kaq të dukshme edhe tek fëmijët e vegjël, pa ja mësuar ndokush? Përse është e domosdoshme t'i mësosh fëmijëve të bëjnë mirë, ndërsa nuk është e nevojshme t'i mësosh ata të bëjnë keq? Mbi këtë argument janë dhënë teori mbi ambientin, mbi zakonet e prindërve, mbi presionet psikologjike, mbi sistemin social-politik. E megjithatë, askush nuk ka qenë në gjendje të mbështesë këto pohime me prova ose të ndryshojë me sukses natyrën e njeriut duke përdorur këto teori.

Shkrimi na thotë se çfarë ka ndodhur. Qeniet e para njerëzore kishin kushtet ambientale ideale, por bënë zgjedhjen e gabuar që t'i mos i bindeshin Perëndisë (Zan. 3). Në këtë pikë hyri mëkati në botë (Rom. 5:12-19) dhe me të një zinxhir me pasoja shkatërrimtare. Gjykimi u bë imediat sepse njeriu ishte qartësisht fajtor (Zan. 3:16-24). Buroi humbja e kushteve të përkryera të ambientit dhe siguria e vdekjes fizike, e dhimbjes dhe e vështirësive për njeriun dhe pasardhësit e tij, nga ai moment deri më sot. E gjitha kjo është quajtur «rënia e njeriut». Pasojat e kësaj rënie janë përshkruar në mënyrë të detajuar tek Zan. 6:5; 8:21; Ps. 12:1-3; Rom. 3:10-23, dhe në pjesë të tjera. Efektet e atij veprimi janë të dukshme edhe sot në natyrën e njeriut. Mëkati ka errësuar zgjuarsinë e tij shpirtërore (Efes. 4:18; 1 Kor. 2:14), duke i dhënë një zemër mashtruese (Jeremia 17:9) duke ndotur në të njëjtën mënyrë mishin dhe shpirtin (Efes. 2:3). Bibla ia atribuon të gjitha konfliktet njerëzore, dhimbjet dhe të këqijat, vetëm një burimi - mëkatis - dhe thotë që ai ka depërtuar në natyrën e vetë njeriut. Ajo pohon që mëkati ka influencuar në të gjithë krijimin, në kuptimin fizik, tek ferrat në krijimin botanik dhe tek dhuna në botën e kafshëve.

## **Përgjegjësia e njeriut**

Njeriu është përgjegjës përpara një Perëndie të dashur dhe të kujdesshëm. Perëndia e ka në konsideratë të lartë njeriun (Mt. 10:31) dhe e mban të denjë për sakrificën më të madhe (Gjo. 3:16). Ky interesim, plot dashuri vërehet edhe tek sjellja e Jezusit, ndërsa qante për një qytet që e kishte refuzuar (Luka 19:41); Ai donte ta shpëtonte, por banorët nuk donin (Luka 13:34).

Njeriu nuk është i pavarur dhe padron i vetvetes (autonom), megjithëse shpesh mendon dhe vepron sikur të ishte i tillë. U krijua nga dora e një Krijuesi dhe Mbrojtësi nga i cili varet edhe për frymëmarrjen (Isa. 42:5). Njeriu do ta takojë një ditë Krijuesin e tij dhe t'i japë llogari për veprimet e tij (Rom. 14:12; Heb. 9:27). Ekzistojnë dy alternativa, të përshkruara tek Gjo. 3:36 dhe tek 1 Gjo. 5:12. Njeriu duhet të zgjedhë.

## **Pyetje - Mësimi 4**

Është e rëndësishme të njohim natyrën tonë si njerëz: nga vijmë, përse ekzistojmë dhe cili është shkaku i problemeve tona.

### **1. Origjina e njeriut (zgjidh një frazë)**

- a. duhet të kërkohej në evoluimin e formave elementare të jetës
- b. është një mister që nuk mund ta kuptojmë
- c. është në dorën krijuese të Perëndisë
- d. bën pjesë në një cikël të ekzistencës që nuk ka një fillim

### **2. Ne ekzistojmë (zgjidh një mundësi)**

- a. për të përmbushur fatin tonë personal
- b. për të rritur potencialin tonë
- c. për ta shijuar jetën në mënyrën më të mirë që mundemi
- d. në mënyrë unike për të lavdëruar Perëndinë

### **3. Cili është funksioni ose aktiviteti i pjesëve të poshtëshënuara të njeriut:**

- a. trupi:
- b. fryma:
- c. shpirti:

4. Sipas jush, çfarë domethënie ka ngjashmëria e përmendur tek Zanafilla 1:26? Në çfarë mënyre jemi sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë?

5. Duke parë botën që të rrethon, çfarë prove kap për të mbështetur mësimin që jep Bibla sipas së cilit njeriu është mëkatar nga natyra dhe nga zgjedhja?

### **6. Zgjedhja e lirë e njeriut ose mundësia e tij për të zgjedhur:**

- a. është një iluzion sepse qëllimet e Perëndisë do ta mundin
- b. është e kufizuar deri në atë pikë që ai nuk është me të vërtetë përgjegjës
- c. i jep mundësi njeriut të zgjedhë që të dojë dhe t'i bindet Perëndisë
- d. është bërë e pamundur nga rrethanat e vështira

7. Shkruaj me fjalët e tua Psalmin 139:14-16.

8. Në çfarë mënyre vargjet e mëposhtme tregojnë që Perëndia i ka dhënë njeriut të drejtën të zgjedhë dhe e ka bërë bazë për vendimet e drejta (LiP. 30:15,19; Jozue 24:15; Zbu. 20:12-13)?

9. Çfarë mendon ti? Shprehu shkurt, me fjalët e tua, kush është sipas teje përgjegjësia jote para Perëndisë. Në çfarë mënyre Perëndia mund të kënaqet dhe të marrë lavdi nëpërmjet jetës tënde?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre vetë gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

(1) Nga ka ardhur njeriu?

(2) Për çfarë qëllimi ekziston njeriu?

(3) Cili është, sipas jush, qëllimi kryesor i jetës?

## PROBLEMI I MËKATIT

Përse ekziston në botë e keqja, dhimbja, vuajtja, luftërat dhe urrejtja? Përse ka lakmi, zili, krenari dhe mizori? Kush është arsyeja që edhe fëmijët veprojnë në mënyrë egoiste, thonë gënjeshtër, nuk binden dhe çojnë në shkatërrim ata që i rrinë afër megjithëse nuk ja ka mësuar ndonjë direkt më parë? E gjitha kjo i dedikohet vetëm një ambienti të keq? Bibla na thotë që rrënjët e gjendjes së njeriut kanë origjinë me lindjen e tij dhe është e mundur t'i vërtetosh më parë se ndonjë nga jashtë të influencojë (Psalmi 51:5; 58:3). Nuk mund t'i kuptojmë plotësisht asnjëherë problemet e njeriut pa diskutuar problemin e mëkatit.

### Koncepte të përgjithshme të mëkatit

Çfarë është mëkati? Një fjalor i përgjithshëm na thotë që është një ofendim ndaj ligjit etik dhe ligjit të Perëndisë, dhe kjo është shumë e qartë. Megjithatë, njerëzit janë larguar nga ky përkufizim i thjeshtë me qëllimin që të fusin ide të ndryshme dhe të çuditshme dhe për më tepër të redaktuara. Ja disa shembuj:

1. MËKATI NUK EKZISTON. I drejtë ose i gabuar qoftë, është thjeshtë një çështje që ka të bëjë me ndryshimin e normave sociale.
2. ÇFARË DEMTON NJË TJETËR ËSHTË MËKATI, por çdo gjë që ti bën personalisht është puna jote.
3. MËKATI KA TË BËJË ME ZAKONET E KËQIJA. Mbahen të tilla nga grupe të ndryshme personazh dhe në mënyra të ndryshme.
4. MËKAT ËSHTË NJË MENDIM I GABUAR OSE NJË GJYKIM I KEQ
5. MËKATI NUK I PËLQEN PERËNDISË POR NUK ËSHTË DIÇKA E RENDE. Të gjithë e bëjmë sepse në fund të fundit jemi vetëm njerëz.

### Koncepti biblik i mëkatit

Idetë e lartpërmendura bien në kontrast me atë që Bibla na mëson mbi mëkatit që është:

1. Të ndjekësh rrugën tënde (Isa. 53:6).
2. Të thyesh ligjin e Perëndisë (1 Gjo. 3:4).
3. Rebelim kundër Perëndisë (1 Gjo. 3:4).
4. Të dish të bësh mirë dhe mos ta bësh (Jak 4:17).
5. Të veprosh jo sipas besimit (Romakëve 14:23).
6. Të mos besosh tek Jezusi (Gjo. 16:9).
7. Çdo papastërti ose të veprosh në mënyrë të gabuar (1 Gjo. 5:17).
8. Gjithçka që është e kundërt nga karakteri i Perëndisë (Rom.3:23).

Gjërat e tjera të këqija që dalin nga zemra e njeriut, ndërmjet të cilave mendimet e këqija, imoraliteti, tradhtia bashkëshortore, lakmia, smira, shpifja, mendjemadhësia, budallallëku, janë të shkruara tek Marku 7:21-23. Asnjë mëkat nuk i fshihet syve të Perëndisë (Psalmi 90:8). Mëkatet tona janë një ofendim kundër Perëndisë sepse Ai është përsosurisht i shenjtë (Psalmi 145:17; Isa. 6:3-5; Habakuku 1:13). N.q.s. nuk do të ekzistonte Perëndia nuk do të ekzistonte mëkati, sepse nuk do të ekzistonte asnjë Qenie e përkryer që të ishte si model për atë që është e drejtë.

### Origjina dhe pasojat e mëkatit

Shembulli i parë i mëkatit që na sillet ka ndodhur në qiell. Engjëlli Lucifer dëshiroi të ishte si Perëndia (Isa. 14:12-14). Mëkati i tij u bë krenaria (Ezekieli 28:15-17) dhe për këtë mëkat u përzu nga qielli dhe u bë Satan. Njëpërmjet tundimit të familjes së parë njerëzore, ai futi mëkatit në botë. Ky mëkat u bë mosbindja ndaj Perëndisë (Zanafilla 2:16-17; 3:1-6). Njeriu u bë përgjegjës për mëkatit dhe i gjykuar si rrjedhim (Zan. 3:16-24).

Vërehet tek Zanafilla 3 që qeniet e para njerëzore humbën bashkësinë me Perëndinë. Gjykimi i tyre konsistonte në ndarjen nga prania e Tij. U bënë objekt në fillim të vdekjes fizike, që është ndarja e shpirtit nga trupi; menjëherë eksperimentuan vdekjen shpirtërore, që është në fakt ndarja e shpirtit nga bashkësia me

Perëndinë. Zbuluan të vërtetën e pohimit klasik të Biblës: «Paga e mëkatit është vdekja» (Romakëve 6:23). Paga është diçka që e fitojmë dhe që na pret. «Shpirti që mëkaton do të jetë ai që do të vdesë» (Ezekieli 18:4). Vdekja është vetëm paga e mëkatit. Të tillë vdekje përmbledh edhe vdekja e dytë (Zbu 20:14). që do të thotë ndarje e përjetshme nga Perëndia. Mëkatet e njerëzve janë të regjistruara në qiell dhe do të përdoren si bazë për gjykimin (Zbu. 20:12). Paratë, lutjet, shkuarjet në kishë dhe veprat e mira, nuk mund ta paguajnë kurrë borxhin e mëkatit.

### **Perëndia do dhe pranon mëkatarët**

Është çuditërisht e vërtetë që një Perëndi i shenjtë, me gjithë urrejtjen e Tij për mëkatin, e do mëkatarin. «Perëndia tregon madhësinë e dashurisë së Tij për ne, sa që, ndërsa ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne» (Romakëve 5:8). «Nuk është se ne e kemi dashur Perëndinë, por Ai na ka dashur ne» (1 Gjo. 4:10). Ai e ka treguar këtë dashuri duke dërguar Birin e Tij të vetëm për të na shpëtuar (Gjo. 3:16). Nëpërmjet vdekjes së Birit të tij për ne, Perëndia mund të na ofrojë faljen (Veprat 13:38; Efes. 1:7).

Pranimi i mëkatit tënd duhet të paraprijë çdo dëshirë të sinqertë për falje. Psalmisti thoshte: «Unë i di prapësitë e mia, dhe mëkati im është vazhdimisht përpara meje» (Psalmi 51:3); ngrinte zërin e tij për t'u pastruar dhe nuk mohonte asnjë nga mëkatet që kishte bërë kundër Perëndisë. Djali i humbur thoshte: «Unë do të ngrihem dhe do të shkoj tek babai im, dhe do t'i them: Baba, kam mëkatur kundër qiellit dhe kundër teje» (Luka 15:18). Shpëtimtari ynë tregon historinë e dy burrave që luteshin. Njëri nga të dy nuk kishte kurajën të ngrinte sytë drejt qiellit, por godiste gjoksin duke thënë: «O Perëndi, ji zemërmirë drejt meje që jam mëkatar!» Jezusi e deklaroi atë njeri të justifikuar (Luka 18:13-14). Fryma e Shenjtë e Perëndisë vepron për t'i çuar njerëzit në bindjen intime për mëkatin (Gjo. 16:8-11).

### **Perëndia thërret mëkatarët për pendim**

«Unë nuk kam ardhur të thërras të drejtë, por mëkatarët që të pendohen» (Luka 5:32). Vepra bindëse e Frymës i çon njerëzit në pendim (Gjo. 16:8). Domethënia elementare e fjalës është «ndryshim idesh». Në Shkrim përdorimi i saj nënkupton një ndryshim idesh duke i kthyer shpinën mëkatit, në mënyrë që të kthehesh drejt Perëndisë. Thirrja e Dhiatës së Vjetër ishte «kthehuni tek unë» (Zakaria 1:13). Është vetëm mirësia e Perëndisë që na udhëheq në pendim (Romakëve 2:4). Mendohet për mëkatet e bëra dhe ndjehet trishtim që i kam bërë (2 Kor. 7:9-10). Pendimi vepron në mënyrë që prodhon një ndryshim të vërtetë, në vend të fjalëve të kota (Mateu 3:8; Luka 13:3,5; Veprat 26:20). Predikimi i parë i krishterë i nxiste njerëzit për pendim (Veprat 2:38; 3:19; 17:30). Një veprim i tillë nuk na bën të pranueshëm nga Perëndia por na bën të njohim gjendjen tonë të mjerë. Pendim përpara Perëndisë dhe besim tek Zoti ynë Jezu Krisht janë veprime që bëhen njëra pas tjetrës si përgjigje e drejtë ndaj thirrjes së Perëndisë (Veprat 20:21). Pendimi nuk është një veprim që na bën të meritojmë shpëtimin; me anë të pendimit i përgjigjemi ftesës për pendim, pranojmë të keqen e mëkatit tonë, duke dëshiruar ndryshimin tonë (Isa. 55:7).

### **Nevoja për vetëshqyrtim**

Është e rëndësishme të dimë që jemi të humbur n.q.s. nuk kemi pasur asnjëherë një takim personal me Shpëtimtarin (Luka 19:10). Kjo gjendje humbjeje i dedikohet mëkatit - prandaj duhet të pendohemi, duke ju drejtuar Perëndisë.

#### *Lista e kontrollit*

1. Ke qenë ndonjëherë egoist?
2. Nuk ke qenë asnjëherë lakmues ose ke dëshiruar ndonjëherë me zjarr diçka?
3. Ke bërë gjithmonë të mirën që dije ta bëje?
4. Ke qenë gjithmonë i sjellshëm dhe plot me respekt ndaj të gjithëve?
5. E ke dashur gjithmonë Perëndinë me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin, mendjen dhe forcën tënde?
6. I ke dashur gjithmonë të tjerët si veten tënde?
7. Ke qenë gjithmonë i përkryer ashtu siç ishte Zoti Jezus?

N.q.s. përgjigjja e ndonjërës nga pyetjet është «JO», Bibla thotë që je një mëkatar. Të kesh zbatuar të gjithë ligjin dhe të jesh fajtor vetëm se ke thyer një pikë je fajtor në të gjitha pikat (Jak 2:10). Vetëm një thyerje e shenjtërisë së përkryer të Perëndisë e bën njeriun mëkatar.

Zoti Jezus erdhi për të shpëtuar «popullin e Tij nga mëkatet e tyre» (Mateu 1:21). Fuqia dhe ndëshkimi i mëkatit janë të tmerrshme. Mundësia e vdekjes së dytë është e frikshme. Psalmisti shkruan: «Lum ai që thyerja i është falur dhe të cilit mëkati i është mbuluar! Lum njeriu të cilit i Përrjetshmi nuk ja ngarkon papastërtinë» (Psalmi 32:1-2).

Është e dobishme për një njeri që thotë se është i krishterë por që praktikon mëkatin si normë të jetës, të reflektojë mbi këtë pyetje: «N.q.s. një njeri nuk është i shpëtuar nga mëkatet e tij, nga çfarë gjeje është i shpëtuar?»

## Pyetje - Mësimi 5

Pyetjet e mëposhtme mund të të ndihmojnë për të sqaruar problemin më të madh të njeriut.

1. Shkruaj me fjalët e tua një përkufizim për mëkatin, mbasi të kesh konsideruar Mateu 5:28; Rom. 3:23; Jak. 4:17 dhe 1 Gjo. 3:4.

Rishkruaj me fjalët e tua Isaian 53:6.

2. Sipas Isaia 14:12-14 dhe Ezekieli 28:15-17, mëkati e ka origjinën në qiell dhe i gjeti rrënjët e tij (zgjdh një përgjigje)

- a. tek krenaria
- b. në mungesën e një drejtimi të mirë
- c. në një ngatërrësë

3. Sipas Zanafillës 2:17; 3:1-6, mëkati i parë mbi tokë u shkaktua (zgjdh një mundësi)

- a. nga mosbesimi dhe nga mosbindja
- b. nga imoraliteti dhe nga sensualizmi
- c. nga zemërimi dhe nga zhgënjimi
- d. nga një ngatërrësë

4. Cili është qëndrimi i Perëndisë ndaj mëkatit (Habakuku 1:13)?

Çfarë page kërkonte Perëndia për mëkatin në Dhiatën e Vjetër (Ezekieli 18:20? Po në Dhiatën e Re (Romakëve 6:23)?

5. Në Shkrim janë përmendur tre tipe vdekjesh: (a) vdekja fizike (ndarja e shpirtit nga trupi); (b) vdekja shpirtërore (ndarja e shpirtit të njeriut nga shpirti i Perëndisë); (c) «vdekja e dytë» (ndarja e përjetshme e shpirti të njeriut nga shpirti i Perëndisë, që ndodh kur njeriu vdes fizikisht, duke pas qenë në vdekje shpirtërore).

Çiftëzo vargjet e kolonës nga e djathta me tipin e vdekjes nga e majta:

- |                     |                  |
|---------------------|------------------|
| _vdekja fizike      | a. Ef 2:1-3      |
| _vdekja shpirtërore | b. Heb. 9:27     |
| _«vdekja e dytë»    | c. Zbu. 20:11-15 |

6. Sipas Rom. 5:8, për kë vdiq Jezusi? Ka dy tipe mëkatarësh, siç është ilustruar nga pjesa e Llukës 18:10-14: ata që e pranojnë që janë mëkatarë dhe ata që nuk e pranojnë. Përse është e rëndësishme të pranojmë se jemi mëkatar?

7. Pendim do të thotë (zgjidh një përgjigje)

- a. një rit fetar që duhet bërë në ditë të caktuara
- b. një ndryshim i mendimeve që sjell si rrjedhim ndryshimin e veprimeve
- c. t'i thuash Perëndisë «më vjen keq»
- d. që jemi të palumtur se si kanë shkuar gjërat

8. Për të marrë faljen e Perëndisë, duhet (zgjidh një përgjigje)

- a. të pranojmë mëkatet tona
- b. të pranojmë përgjegjësinë tonë për mëkatet
- c. t'i përgjero kemi Perëndisë për pastrimin
- d. të jemi të gatshëm të braktisim mëkatin
- e. të bësh gjithçka që u tha në përgjigjet e mësipërme

9. Çfarë mendon? Si dhe kur je bindur për herë të parë për mëkatin dhe ke ndjerë nevojën për një Shpëtimtar?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

1. Sipas jush, çfarë është mëkati?
2. Duke parë TV, duke lexuar gazetatat, ka ndonjë gjë që tregon që njeriu është mëkatar?
3. Përballë mëkatit, çfarë mendon se do të bënte një Perëndi i drejtë?

Shëno emrat dhe adresat e tyre mbi skeda të posaçme të përgatitura nga mësuesi. Shkruaj opinionet e tyre, duke shënuar personat të cilët pëlqejnë të japin një përgjigje personale të shkruar.

## Mësimi 6

### SHQYRTOJMË PËRJETËSINË

«POR NJERIU VDES DHE HUMBET ÇDO FORCË; i vdekshmi jep shpirt dhe ... ku është ai?» (Jobi 14:10). Personat që reflektojnë të cilëve nuk i shpëton fluksi i vazhdueshëm i funeraleve e kuptojnë me lehtësi që koha mbi tokë është e kufizuar. Disa ndalojnë për të shqyrtuar ndonjë shpresë, për ta për të jetuar përtej harkut të shkurtër të kohës të kësaj jete. Disa të tjerë, kërkojnë të injorojnë vdekjen dhe jetojnë sikur kjo nuk do të vinte kurrë. Natyrisht, të injorosh diçka nuk do ta ndryshojë kurrë realitetin, por do të evitohet thjesht tmerrin për ta menduar. Herët ose vonë pjesa më e madhe e të gjallëve mendon mbi pyetjen, «Çfarë ndodh pas vdekjes?» Teoritë e tyre mund të rreshtohen në nën pika të ndryshme:

1. **MOS-EKZISTENCA.** Shpesh, kjo emërtohet me termin «asgjësim». «Kur vdes, vdes», dhe qenia jote asgjësohet.
2. **RITRUPËZIMI.** Një person që ka vdekur mund të kthehet mbi tokë në forma të ndryshme jete ose në trupin e një personi tjetër. Me sa mund të parashikohet, kjo do të kërkonte një fuqi mbinatyrore të ndonjë lloji.
3. **KOMUNIKIMI I SHPIRTRAVE.** I vdekuri jeton në një botë misterioze shpirtrash dhe mund të përpiket të mbajë lidhje me ata që jetojnë mbi tokë.
4. **ËSHTË E PAMUNDUR TA DISH.** Gjendja jonë, pas vdekjes, është përtej njohjes njerëzore. Nuk dihet n.q.s. ekziston ose jo jeta mbas vdekjes. Duhet të presim dhe të shikojmë se çfarë ndodh dhe, në rast se ka jetë mbas vdekjes, të shpresojmë tek fati ose në jetën tonë të harxhuar mirë.

Asnjëra nga këto teori nuk shkon me atë që na mëson Bibla. Kjo i paraqet ata që kanë vdekur si qenie të ndërgjegjshme dhe të vetëdijshëm në njërin nga dy vendet e poshtë shënuara: në prani të Perëndisë (2 Kor. 5:8) në një gjendje të bekuar (Zbu. 14:13), ose të ndarë nga Perëndia, në një vend me tmerr të madh (Zbu. 20:10, 15).

### Ringjallja e të vdekurve

Fjala «ringjallje» do të thotë «të qëndrosh në këmbë» ose «ngrihem». Zoti Jezus, duke ju përgjigjur atyre të kohës së Tij të cilët mohonin ringjalljen, nxori në pah që emri i Perëndisë i ishte atribuar njerëzve të mëdhenj që kishin vdekur prej kohësh. «Ai nuk është një Perëndi i të vdekurve, por i të gjallëve» (Luka 20:37-38). Shpallja e ringjalljes u bë themelore për predikimin apostolik (Veprat 1:22; 4:2; 17:18; 23:6). Apostulli Pal thotë që ishin më shumë se 500 dëshmitarë për ringjalljen e Krishtit (1 Kor. 15:4-8) dhe n.q.s. kjo nuk do të ishte e vërtetë, i kotë ishte besimi i tyre (15:12-17). E vërteta e jashtëzakonshme e Shkrimit, në çdo mënyrë, është se janë dy klasa në ringjallje, të ndara me kujdes nga njëra-tjetra.

«Dhe shumë prej atyre që flenë në pluhurin e tokës do të zgjohen; disa për jetën e përjetshme, disa për në turp, për në vuajtje të përjetshme» (Dan. 12:2).

«Të gjithë ... do të dalin jashtë: ata që kanë punuar mirë, do të ngjallen për të marrë jetën e përjetshme, dhe ata që kanë punuar keq, do të ngjallen për të marrë dënimin» (Gjo. 5:28-29).

«Do të jetë një ringjallje e të drejtëve dhe e të padrejtëve» (Veprat 24:15b).

Duke konsideruar gjykimin e Perëndisë, janë dy mundësi përpara njerëzve. Një mundësi e tmerrshme është gjykimin e përjetshëm (Heb 6:2; 9:27); tjetra është jeta e përjetshme (Gjo. 3:16) dhe për të liria nga ai gjykim dënimi (Gjo. 5:24; Rom. 8:1).

### Shtrirja e përjetësisë

Është e çuditshme që fjalë të Biblës si «përjetësi», «i përjetshëm», «në shekuj të shekujve» janë mësuar sikur të kishin kufizime. Megjithatë, disa kanë parë gjuhët origjinale të Shkrimit dhe janë përpjekur të demonstrojnë që këto shprehje tregojnë një periudhë të papërcaktuar. Përdorimi i këtyre termave në Shkrim dëshmon, pikërisht, që nuk ka asnjë kufizim për zgjatjen e përjetësisë, megjithëse e përkthyer «nga epoka në epokë».

Vargjet e mëposhtme tregojnë aplikimin e termit «i përjetshëm».

1. **E ZBATUAR PËR PERËNDINË.** «I Përjetshmi Perëndi» (Rom. 16:26), «Fryma e përjetshme» (Heb. 9:14), «lavdia e përjetshme» (1 Pje 5:10), «fuqi e përjetshme» (1 Tim. 6:16), «mbretëri e përjetshme» (2 Pjetrit 1:11).
2. **E APLIKUAR PËR TË ARDHMEN E BESIMTARIT.** «Çlirim i përjetshëm» (Heb. 9:12), «shpëtim i përjetshëm»



(Heb. 5:10), «jetë e përjetshme» (Gjo. 3:15,16,36; Luka 18:30).

**3. E APLIKUAR PËR TË ARDHMEN E JOBESIMTARIT.** «Zjarr i përjetshëm» (Mateu 18:8), «dënim i përjetshëm» (Mateu 26:46), «shkatërrim i përjetshëm» (2 Thes. 1:9).

E njëjta gjë është edhe për shprehjen «në shekuj të shekujve». Përdoret për Perëndinë dhe fronin e Tij (Zbu. 4:9-10; 10:6; 15:7), për mbretërinë e ardhshme të besimtarëve me Zotin (Zbu. 22:5), për tmerrin pa fund (Zbu. 14:11; 20:10).

Besohet që shprehje të tilla, si «shkatërrim», «të humbasësh» dhe «të konsumosh», tregojnë në thelb asgjësim. Megjithatë, është e qartë që djalli është shkatërruar (Heb. 2:14), por nuk është asgjësuar (Zbu. 20:10); besimtarët mund të konsumohen nga fjalët e të tjerëve, por nuk mund të asgjësohen nga kjo (Gal. 5:15). Djali i humbur po vdiste, megjithatë ai nuk mbarojë së ekzistuari si person (Luka 15:17). Fati i të gjithë atyre që nuk besojnë është shkatërrimi i përjetshëm (2 Thes. 1:9) dhe fakti që shkatërrimi është i përjetshëm, dëshmon që kjo nuk implikon një mbarim të ekzistencës. Është humbja e gjendjes së mirëqenies, por jo humbja e së qenies (ekzistenca).

### Gjendja e të humburve

1. SI E KA PËRSHKRUAR JEZUSI. Zoti Jezus tregoi një histori, atë të të pasurit në ferr, që disa e përshkruajnë si shëmbëlltjërë (Luka 16:19-31), megjithëse Bibla nuk e përcakton si të tillë. Megjithatë, edhe sikur të ishte shëmbëlltjërë, përdorimi i gjuhës simbolike nuk anulon të vërtetën mesimdhënëse në këtë pjesë. Shpëtimtari kërkoi të mësonte diçka nëpërmjet kësaj historie dhe do të bëjmë mirë n.q.s. reflektojmë me vëmendje mbi mësimet që na jep:

- a. Jeta nuk mbaronte mbas vdekjes.
- b. Shpirtrat nuk ishin të pavetëdijsëm.
- c. Nuk ishte shpëtimi i të gjithë njerëzve.
- d. Nuk ofrohej një mundësi e dytë.
- e. Nuk kishte ritrupëzim ose kthim mbi tokë.
- f. Mundimi ishte pa fund dhe nuk kishte shpresë se gjërat mund të ndryshonin për ata që nuk ishin të shpëtuar.
- g. Nuk kishte asnjë qëllim për pastrim, por vetëm ai i dënimit të përjetshëm.

2. SI NA E KA MËSUAR ME TEJ JEZUSI. Përshkrimet e tmerrshme të mëposhtme janë dhënë të gjitha nga Ai që desh me një dashuri të pakufishme, dha veten e Tij për të shpëtuar njerëzit. Ai tha thjesht të vërtetën mbi ata që linin këtë botë duke e përçmuar dhe duke e refuzuar Atë.

- a. Zjarr që nuk shuhet (Mateu 3:12; 18:8; Marku 9:44,48)
- b. Mundim i përjetshëm (Zbu. 14:11)
- c. Terr (Mateu 22:13; 25:30)
- d. Vajtje dhe kërcëllitje dhëmbësh (Mateu 13:42,50; 24:51; Luka 13:38)
- e. Liqen i zjarrtë (Zbu. 20:15)

### Vërejtje për doktrinën e dënimit të përjetshëm

Janë të shumta vërejtjet e bëra kundër kësaj doktrine jopopullore.

**1. ËSHTË I PAPAJTUESHËM ME DASHURINË E PERËNDISË.** «Siç është e vërtetë që Unë jetoj, thotë Zoti, i Përjetshmi, Unë nuk kënaqem me vdekjen e të pabesit; por dua që i pabesi të kthehet nga rruga e tij dhe të jetojë: kthehuni ... nga rrugët tuaja të mbrapshta! Përse do të vdisni ju?» (Eze. 33:11). Zoti Jezus donte një qytet që e kishte hedhur poshtë Atë dhe qau për të (Luka 19:41). Ai është në fakt një Perëndi i dashur, por duke qenë i drejtë, nuk mund të shpallë të pafajshëm fajtorin që refuzon shpëtimin e Tij (Num. 14:18).

**2. NUK ËSHTË ARSYE E MIRË TË VRAPOSH PËR TE FRIKA.** Mund të jetë e vërtetë që dashuria e Perëndisë ose dëshira për të mirën e tjetrit të jenë arsye të mira; megjithatë, frika për pasoja serioze është një masë e përbashkët parandaluese për sjelljen e keqe ose edhe për padrejtësitë e jetës së përditshme. Zoti Jezus ju drejtua pikërisht ndrojtjes ndaj Perëndisë dhe gjykimit të Tij të afërt (Mateu 10:28). Shkrimi thotë t'i ndruhen Perëndisë është parimi i ditorisë (Fja. 9:10). Nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta njerëzit nxiten që t'i ndruhen Perëndisë, në

kuptimin e vërtetë të fjalës (1 Pje 2:17; Zbu. 14:7; 15:4).

**3. ËSHTË E PADREJTË NGA ANA E PERËNDISË TË JETË KAQ I EGËR.** Njerëzit të cilët kanë gjetur një mënyrë që t'i shmangen një Perëndie që i do dhe që i janë përgjigjur kësaj dashurie me një refuzim, duke nxjerrë justifikime ose duke e shtyrë vendimin e tyre, nuk duhet të mrekullohen n.q.s. marrin një drejtësi të sigurt nga ana e një shenjtërie të fyer. «Mos u mashtroni: Perëndia nuk mund të vihet në lojë; sepse atë që njeriu do ketë mbjellë, atë do të korrë» (Gal. 6:7). Të fyesh dashurinë e pafund dhe durimin e pafund të një Perëndie të pafund kërkon një dënim të pafund.

### Gjendja e të çliruarve

Gjendja finale e të drejtit është në kontrast me atë që folëm më sipër. «Prania jote më mbush me gëzim, dhe më sjell kënaqësi përgjithmonë» (Psalmi 16:11). «Që tani, të lumtë ata që vdesin në shërbim të Zotit» (Zbu. 14:13). Besimtari pret «qytetin që ka themele të vërteta i të cilit arkitekt dhe konstruktor është Perëndia» (Heb. 11:10). Ky vend është më i miri se çdo tjetër e botës. Tani do të shikojmë kushtet e përjetshme të besimtarit dhe banesa e tij e përhershme:

**1. ME KRISHTIN.** «Unë po shkoj t'ju përgatit një vend ... që atje ku të jem unë të jeni edhe ju» (Gjo. 14:3; 17:24). «Të largohesh nga trupi» do të thotë «të banosh me Zotin» (2 Kor. 5:8).

**2. NË NJË TRUP TË TRANSFORMUAR.** Do t'i ngjajë atij të Jezusit (Fil. 3:21) dhe do të jetë kështu i pakorruptueshëm (1 Kor. 15:35-44). Ringjallja për ata tek Krishti do të ndodhë me ardhjen e dytë të Krishtit (1 Thes. 4:15-17).

**3. NË NJË VEND KU «S'KA ME».** Nuk është me vdekja, s'ka trishtim, s'ka vajtim, s'ka dhimbje dhe gjithçka që e bën jetën të vështirë dhe të palumtur nuk do të jetë më (Zbu. 21:4).

**4. NË NJË VEND ME BUKURI TË PAFUND.** «Qyteti ishte me arë të pastër, i ngjashëm me xhamin e pastër» (Zbu. 21:18-21). Është i zbukuruar me gurë të çmuar të çdo lloji.

**5. NË NJË VEND KU NUK DO TË GJENDET ASGJË E PAPANË OSE NDOTESE** (Zbu. 21:27).

Vendi i të shenjtëve shpesh quhet «Jerusalemi i Ri». Ne e quajmë «qiell». Çifutët e quanin «parajsë». Sido që ta quajmë, ai duhet të jetë objekti i dëshirës së çdo besimtari. Në fakt Pali thoshte: «të vdesësh është fitim» (Fil. 1:21). Ç'fjalë të mrekullueshme ishin ato që Zoti Jezus ia drejtoi hajdutit mbi kryq i cili ishte penduar për mëkatet e tij dhe kishte besuar tek Ai: «Sot ti do të jesh me mua në parajsë» (Luka 23:43). Dëshiron edhe ti të jesh atje me Të një ditë?

### Pyetje - Mësimi 6

«N.q.s. një njeri vdes, do të jetojë ai përsëri?» Kjo pyetje e bërë nga njëri prej antikëve, është akoma me rëndësi të madhe edhe sot. Çfarë ndodh pas vdekjes?

1. Bibla i paraqet ata që kanë vdekur si qenie të vetëdijshme dhe të ndërgjegjshme, në njërin prej dy vendeve. Cilët janë këto dy vende (2 Kor. 5:8; Zbu. 20:10,15)?

2. Bibla thotë që të gjithë ata që vdesin do të ringjallen nga të vdekurit. Përshkruaj dy fatet e ndryshme të njerëzimit (Danieli 12:2; Gjo. 5:28-29; Veprat 24:15b).

3. Shkruaj me fjalët e tua vargjet e mëposhtme: Gjo. 3:16; 2 Thes. 1:8-9.

4. Sa zgjat përjetësia? Mund ta përshkruash me një shembull?

5. Jezusi tregoi për një njeri që shkoi në ferr (Luka 16:19-31). Sipas kësaj pjese, cilat nga frazat e mëposhtme

është e vërtetë (zgjidh një)?

- a. Një person mbaron thjesht së ekzistuari kur vdes
- b. Një person i vdekur jeton një gjendje të pavetëdijshme ose «gjumë të shpirtit»
- c. Ferri është një vend i mundimeve të vetëdijshme, pa fund
- d. Të gjithë njerëzit do të shpëtohen
- e. N.q.s. një njeri shkon në ferr, do të ketë një mundësi të dytë për t'u shpëtuar

6. Cilat nga shprehjet e mëposhtme nuk përdori Jezusi për të përshkruar ferrin (zgjidh një)?

- a. Zjarr i pashuar
- b. Vuajtje e përjetshme
- c. Errësi
- d. Vuajtje dhe kërcëllitje dhëmbësh
- e. Një vend i një pastrimi të përkohshëm
- f. Liqen i zjarrtë

7. Përgjigju vërejtjeve të mëposhtme.

a. Doktrina e ferrit është e papajtueshme me dashurinë e Perëndisë.

b. Ky mësim na çon tek frika.

c. Nuk është e drejtë nga ana e Perëndisë që të jetë kaq i egër.

8. Bibla e përshkruan të ardhmen e besimtarit në qiell si (zgjidh një mundësi):

- a. Të jesh gjithmonë me Krishtin
- b. Ekzistenca në një trup të transformuar
- c. Të mos jesh më në trishtim dhe në dhimbje
- d. Të jesh në një vend ku nuk ka papastërti dhe ndotje
- e. Gjithçka që u tha më lart
- f. Frazat «a» dhe «c»

9. Çfarë mendon? Në eksperiencën tënde shpirtërore ke arritur ndonjë herë në pikën në të cilën me siguri e dije se do të shkoje në qiell sikur të vdisje atë natë? Shpjegoje.

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre këto pyetje:

(1) Sipas jush, çfarë ndodh me një njeri kur vdes?

(2) Çfarë i thonë atij shprehjet «parajsë» dhe «ferr»?

(3) N.q.s. do të bënit pyetje mbi përtej vdekjen dhe do të merrnit përgjigje të besueshme, çfarë do të kërkonit?

## Mësimi 7

### JEZUS KRISHTI: PROVIDENCA E PERËNDISË

«UNË E DI QË MESIA (që është quajtur Krisht) DO TË VIJË», tha gruaja samaritane. «Jezusi i tha: `Unë që po të flas jam ai'» (Gjo. 4:25-26). Pak kohë më parë një peshkatar nga Galilea i kishte thënë vëllait të tij: «Kemi gjetur Mesian (që do të thotë: Krishtin)» (Gjo. 1:41). Krishti ishte Ai që do të sillte «drejtësinë e përjetshme» duke vendosur mbretërinë e Tij të përjetshme. Jezusi nga Nazareti lindi rreth 2000 vjet më parë dhe data e lindjes së Tij mbahet si pika që ndan gjithë historinë. Është njohur si i Zgjedhuri i profetizuar nga Shkrimet e Shenjta antike. Ai erdhi si:

1. Mbreti i premtuar dhe Çliruesi i popullit çifut (2 Sam. 7:11-13).
2. Atë që Perëndia e ka dërguar për të qenë Shpëtimtari i botës (Luka 2:11; Gjo. 4:42).
3. «Perëndia me ne» (Emanuel), Çliruesi hyjnor (Mateu 1:23; Isa. 7:14).

#### Profecitë që i përkasin Jezu Krishtit

Nuk mund të mohohet rëndësia e Jezu Krishtit (Jezus Mesia), edhe duke konsideruar vetëm jetën e Tij dhe ndeshjen me botën historike. Ajo është pa asnjë barazim dhe është përforcuar nga një sasi e madhe dëshmisë nga Shkrimet e Dhiatës së Vjetër, të shkruara shumë kohë para lindjes së Tij. Identifikimi kompletohet duke bashkuar çdo profeci me detajet e jetës së Tij. Janë më shumë se 200, prej të cilave kemi sjellë këto shembuj:

1. Pasardhësi i gruas (Zan. 3:15; Gal. 4:4).
2. Lindja në Betlehem (Mikea 5:2; Mateu 2:1, 4-6).
3. Lindja e Tij nga një virgjëreshë (Isa. 7:14; Mateu 1:18, 23-25).
4. Paraardhësi i Tij (Isa. 40:3; Mateu 3:1-3).
5. Hyrja e Tij në Jerusalem (Zakaria 9:9; Luka 19:35-38).
6. Refuzimi i të tjerëve (Isa. 53:3; Psalmi 69:8; Gjo. 7:5; 19:15).
7. Tradhtia (Zakaria 11:12; Mateu 10:4; 26:14-15).
8. Fshikullimet, përbuzja (Isa. 50:6; Mateu 26:67).
9. Vuajtja për mëkatet e të tjerëve (Isa. 53:5, 1 Pje 2:24; 3:18).
10. Shpimi me heshtë mbi kryq (Psalmi 22:16; Zakaria 12:10; Gjo. 19:34,37).
11. Lutja për armiqtë e Tij (Isa. 53:12; Luka 23:34).
12. Kryqëzimi me kriminelët (Isa. 53:9; Mateu 27:38).
13. I varrosur në një varr të pasurish (Isa. 53:9; Mateu 27:57-60).
14. Ringjallja nga të vdekurit (Psa. 16:8-10; Luka 24:46; Veprat 13:33-35).

Vetë Shkrimet profetizojnë për ardhjen e Tij të dytë (Psalmi 50:3-6; Danieli 7:13; Zakaria 12:10; 14:4, dhe në shumë referime të Dhiatës së Re). Ato parathënë për qeverinë e Tij universale (1 Kro. 17:11-14; Isa. 9:7; Danieli 7:14; Psalmi 2:6-8; 45:6-7; 72:8; 110:1-3).

#### Detyrat e Jezu Krishtit

Zoti Jezus, në një mënyrë unike, përmbodhi në vetvete tre detyrat e mëdha të prejardhura nga Perëndia.

1. ËSHTË NJË PROFET. Është më i madhi ndër gjithë profetët (Marku 6:4; Veprat 3:22). Pikërisht për Të foli Moisiu (LiP. 18:15-19).
2. ËSHTË NJË KRYEPRIFT I MADH. Përfaqëson popullin e Tij përpara Atit dhe lutet për ta (Heb. 4:14-16; 7:25). Për Të flitet tek 1 Sam. 2:35).
3. ËSHTË MBRET, MBRETI I MBRETËRVE (Zbu. 19:16). Erdhi në fillim si Mbret i çifutëve (Gjo. 19:19). Sot

është Mbret në zemrat e popullit të Tij. Do të pranohet nga të gjithë një ditë (Fil. 2:9-10).

### **Hyjnia e Jezu Krishtit**

Bibla pohon që Jezu Krishti ishte Perëndia i zbuluar në mish (1 Tim. 3:16); ishte shëmbëllimi i saktë i Perëndisë së padukshëm (Kol. 1:15). Është e mrekullueshme të konstatosh që Perëndia i gjallë u mishërua (Gjo. 1:1,14). Çfarë trishtimi kur lexojmë që «Ai ishte në botë, dhe bota u bë nëpërmjet Tij, por bota nuk e njohu!» (Gjo. 1:10).

Ishte e nevojshme që Perëndia të na shpëtonte dhe vetëm Ai kishte fuqinë për ta bërë. «Unë, Unë jam i Përrjetshmi, dhe jashtë meje nuk ka Shpëtimtar» (Isa. 43:11). Erdhi si Jezusi nga Nazareti për të qenë «Perëndia dhe Shpëtimtari ynë i madh» (Tit 2:13). Maria tha: «Fryma ime ngazëllon në Perëndinë, Shpëtimtarin tim» (Luka 1:47). Fëmija që do të lindte nga ajo ishte Shpëtimtari i saj dhe Perëndia i saj. Janë të shumta pjesët Biblike që e tregojnë Jezusin si Perëndi.

1. AI U QUAJT DIREKT PERËNDI (Gjo. 1:1,14; 20:28; Rom. 9:5; 2 Pjetrit 1:1; 1 Gjo. 5:20). Ati i drejtohet Birit si Perëndisë (Heb 1:8).

2. ËSHTË QUAJTUR BIRI I PERËNDISË. Dëgjuesit e Tij e kuptuan qartë që ky titull tregonte që Jezusi ishte Perëndia (Gjo. 10:33-36). Është edhe një përdorim më i vogël i termit «bir i Perëndisë», por Jezusi është i vetmi Bir i Perëndisë (Gjo. 1:14,18).

3. E GJITHË TËRËSIA E PERËNDISË BANON TEK AI. (Kol. 1:19; 2:9). Ai nuk është një formë më e ulët e Perëndisë.

4. MBAN EMRAT HYJNOR TË PERËNDISË. Jezusi emërtohet Alfa dhe Omega, I Pari dhe I Fundit, Fillimi dhe Fundi (Zbu. 22:13; 1:8,17; Isa. 44:6). Është edhe UNË JAM (Gjo. 8:24,58; Eksodi 3:14). Në momentin kur Jezusi thoshte që ishte «UNË JAM», Ai deklaronte prejardhjen hyjnore të Tij.

5. ËSHTË ADHURUAR SI PERËNDIA (Mateu 14:33; Gjo. 20:28; Fil. 2:10; Heb. 1:6; Isa. 45:23). Adhurimi i drejtohet vetëm Perëndisë (Mateu 4:10; Zbu. 22:8-9).

6. DUHET TË NDEROHET NJËLLOJ (Gjo. 5:23). Perëndia nuk ja jep lavdinë e Tij ndonjë tjetri (Isa. 42:8).

7. ZOTËRON DETYRA HYJNORE. Është Krijuesi (Kol. 1:16-17; Heb. 1:2,10); është Gjykatësi i të gjithëve (Gjo. 5:22); është Ai që i fal mëkatet (Mateu 9:2-6), ndonëse vetëm Perëndia e bën këtë (Isa. 43:25).

8. KA JETËN NË VETVETE (Gjo. 5:26). Ai i jep jetën të tjerëve, por ekziston për Vetën, se nuk e ka marrë jetën nga askush tjetër.

9. KA TË GJITHË ATRIBUTET HYJNORE. Jezusi nuk ndryshon (Heb. 13:8). Është i gjithëpushtetshëm (Zbu. 1:8), i kudogjendur (Mateu 28:20) dhe ka të gjithë cilësitë e tjera hyjnore (Gjo. 21:17; Mikea 5:2; 1 Tim. 1:16-17).

10. BËN VEPRAT E PERËNDISË. Komandoi elementet (Mateu 8:26-27; Marku 4:39-41); prodhoi bukë për turmën (Mateu 14:19-21; 15:36-38); ngjalli të vdekur (Gjo. 11:32-44; Luka 7:12-16).

### **Natyrë njerëzore e Jezu Krishtit**

Megjithëse ishte plotësisht dhe përjetësisht Perëndi, Ai ishte edhe «Jezu Krishti njeri» (1 Tim. 2:5). Jezusi i referohej shpesh vetvetes si Biri i Njeriut. U vesh me natyrë njerëzore, u bë si ne në gjithçka, duke përjashtuar mëkatet. Provoi emocionet tona; pati uri etj., vuajti, qau dhe ndjeu edhe lodhje. Eksperimentoi tundimin nga ana e Satanit (Mateu 4:1-11). Vuajti, i rrodhi gjak, vdiq, u varros dhe u ringjall nga të vdekurit. Ishte ndryshe nga njerëzit e zakonshëm, megjithëse ishte plotësisht njeri.

1. KISHTE PRINDËR NJERËZOR, origjina e të cilëve kalonte nëpërmjet Davidit ngjitej deri tek Adami (Luka 3:23-38), por lindi nga një virgjëreshë, i ngjizur nga Fryma e Shenjtë (Mateu 1:18-23).

2. KISHTE NJË TRUP NORMAL, si të tjerët (Rom. 8:3; Gjo. 4:9). Ai u rrit deri në moshën e pjekurisë sipas normave të zakonshme (Luka 2:40,52), por jeta e Tij nuk ishte ndotur nga mëkati (Heb. 4:15).

3. ISHTE NJË QENIE E FORMUAR NGA TRE PJESË, si të tjerët. Kishte një trup (Heb. 10:5), një shpirt (Mateu 26:38) dhe një frymë (Luka 23:46); por ai demonstronte një njohje të shkëlqyer të Perëndisë dhe kishte një raport aq intim me Perëndinë që asnjë njeri tjetër s'mund ta kishte.

Mund të kuptohen një pjesë e madhe e sjelljeve të Tij vetëm nga këndvështrimi i Tij i njerëzishëm - si vajtimi mbi kryq (Mateu 27:46) dhe vdekja e Tij.

Pyetja më e rëndësishme që Jezusi ja bëri njerëzve ishte: «Kush thoni ju se jam Unë?» (Mateu 16:15). Tha se n.q.s. nuk do të besonin tek Ai në mënyrën e duhur, do të vdisnin në mëkatet e tyre (Gjo. 8:24).

*Kush thua ti se është Jezusi?*

### Pyetje - Mësimi 7

Jezusi bëri këtë pyetje: «Kush thoni ju se jam Unë?» Ishte me rëndësi të madhe që njerëzit ta njihnin plotësisht dhe të praninin identitetin e Tij. Ekzamino veten tënde për këtë rast.

1. Gruaja samaritane po priste dikë që t'i zbulonte të vërtetën e Perëndisë. Për kë flitej (Gjo. 4:25)?

2. Ardha e Mesias (e përkthyer në Greqisht «Krishti») u paratha qindra vjet më parë në shkrimet e Dhiatës së Vjetër. Kombino vargjet e mëposhtme të kolonës nga e djathta me profecinë përkatëse të kolonës nga e majta.

__ Lindja në Betlehem	a. Isa. 7:14; Mt. 1:18,23-25
__ Lindja e Tij nga një virgjëreshë	b. Isa. 40:3; Mt. 3:1-3
__ Paraardhësi i Tij	c. Isa. 53:5; 1 Pje. 2:24; 3:18
__ Hyrja në Jerusalem	d. Isa. 53:9,12; Mt. 27:38
__ Tradhtia	e. Isa. 53:9; Mt. 27:57-60
__ Vuajtja për mëkatet e të tjerëve	f. Mikea 5:2; Mt. 2:1,4-6
__ I gozhduar mbi kryq	g. Psa. 16:8-10; Luka 24:46; Veprat 13:33-35
__ I kryqëzuar me kriminelët	h. Psa. 22:16; Zakaria 12:10; Gjo. 19:34,37
__ I varrosur në varr të pasurish	i. Zak. 9:9; Luka 19:35-38
__ Ringjallja nga të vdekurit	j. Zak. 11:12; Mt. 10:4; 26:14-15

3. Identifiko tre detyrat e mëdha të Mesias (Krishtit):

- LiP. 18:15-19; Marku 6:4
- 1 Sam. 2:35; Heb. 4:14-16; 7:25
- Zbu. 19:16; Gjo. 19:19; Fil. 2:9-10

4. Në çfarë gjëje Jezusi ishte si gjithë njerëzit e tjerë kur ishte mbi tokë?

Në çfarë mënyrë të ndihmon kjo të kuptosh që Jezusi provoi emocionet njerëzore?

Në çfarë mënyre Jezusi dallohej nga njerëzit e tjerë kur ishte mbi tokë (sipas asaj që është përshkruar në vargjet që vijojnë)?

Mateu 1:23, Gjo. 8:46, Gjo. 7:46, Marku 4:37-41, Luka 7:22.

5. Cilat attribute (cilësi) të Perëndisë i janë atribuar Jezu Krishtit në vargjet e mëposhtme?

Mateu 28:18-20, Marku 2:5-7, 1 Tim. 1:17, Heb. 13:8, Zbu. 1:8.

6. Përgjigju duke vendosur një kryq mbi E VËRTETË ose E GABUAR.

a. Perëndia At i drejtohet Jezusit si Perëndi. (Heb. 1:8) (E vërtetë - E gabuar)

b. Jezusi i la njerëzit që ta adhuronin. (Mateu 14:33; Gjo. 20:28-29) (E vërtetë - E gabuar)

c. Zoti Jezus tha se ishte Perëndia. (Gjo. 8:58; 10:30) (E vërtetë - E gabuar)

7. Kur Jezusi lindi mbi tokë (zgjidh një frazë)

a. Mbaroi të jetë Perëndi duke u bërë njeri

b. Bashkoi te personi i Tij hyjninë me natyrën njerëzore

c. Nuk ishte me të vërtetë njeri sepse ishte Perëndi

d. Kishte Jozefin si baba të vërtetë ashtu siç ishte Maria nëna e Tij e vërtetë

8. Shkruaj me fjalët e tua Gjonin 1:1-3,14.

9. Çfarë mendon? Fil. 2:9-11 thotë që një ditë çdo gju do të thyhet përpara Krishtit. Kur dhe në çfarë mënyre do ta bësh këtë në jetën tënde?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktë tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

(1) Kush është Jezu Krishti?

(2) Bibla na mëson që Perëndia u bë njeri. N.q.s. do t'ju jepej rasti të kalonit pak kohë me Të, kujt do të prisnit se do t'i ngjante?

(3) Shprehjet «Bir i Perëndisë» dhe «Perëndia Bir» duan të thonë për ju të njëjtën gjë?

## DOMETHËNIA E KRYQIT

Kryqi është simboli i madh i besimit të krishterë. Në fakt, mbi kryq vdiq Shpëtimtari ynë. Perëndia urdhëroi «predikimin e kryqit» (1 Kor. 1:17-18). Miliona njerëzve i është mësuar që Krishti vdiq mbi kryq për mëkatet tona. Por çfarë do të thotë kjo saktësisht? Përse ishte e domosdoshme? Çfarë realizojë? Shpesh këto pyetje lënë në një gjendje konfuzioni ata që e shpallin se janë të krishterë.

**Domosdoshmëria e kryqit**

Përse vdekja e Krishtit mbi kryq e bë e domosdoshme? Të shikojmë sa vijon:

1. PERËNDIA ËSHTË I DREJTË DHE I SHENJTË (1 Pje. 1:16; Isa. 6:2-3). Asgjë e papastër s'mund të hyjë në praninë e Tij (Zbu. 21:27).

2. MËKATI DUHET TË GJYKOHET (Rom. 2:3,12). Në asnjë mënyrë Perëndia nuk mund të shfajësojë fajtorin (Eksodi 34:7; Jobi 10:14). I gjithë njerëzimi është fajtor para Perëndisë (Rom. 3:19). Mëkati kërkon dënimin kapital, d.m.th. vdekjen (Rom. 6:23).

Dënimi duhej paguar. Problemi i Perëndisë ishte, si të ishte plotësisht i drejtë e megjithatë të mund të justifikonte mëkatarin (Rom. 3:26). Si mund të bashkoheshin drejtësia dhe e vërteta e Perëndisë me mëshirën e Tij?

**Parimi i zëvendësimit**

Kur një person, ose një gjë, zë vendin e një tjetri gjendemi përballë një zëvendësimi. Zëvendësimi me kafshë i mëkatarit simbolizonte afrim tek Perëndia në Dhiatën e Vjetër. Qengji i pashkës u sakrifiku me vdekje si mbrojtje ndaj gjyqimit të Perëndisë (Eksodi 12:3-17). Miliona sakrifica si ky ju ofruan Perëndisë, sipas asaj që Ai vetë kishte urdhëruar. Oferta të tilla bënë atë që është quajtur «shlyerje» (Lev. 5:10). Kjo do të thoshte që mëkati ishte «mbuluar» nga vdekja e një viktime të pafajshme.

Është e rëndësishme të vëresh që Gjon Pagëzori e përshëndeti publikisht Jezusin si «Qengji i Perëndisë që i heq mëkatin botës» (Gjo. 1:29). Ai shikon te Jezusi të vetmin që do të ishte viktimë e vërtetë shlyese, drejt të cilit do të shiheshin të gjitha sakrificat e bëra më parë. Ai duhet të ishte i vërteti i vetëm dhe i fundit Zëvendësues. Profetët e parathanë qartë që Mesia që do të vinte do të goditej nga Perëndia për mëkatet e të tjerëve, duke marrë kështu mbi vete edhe gjykimin e tyre (Isa. 53:4-6). Qendra e predikimit të krishterë është se «Krishti vdiq për mëkatet tona, sipas shkrimeve» (1 Kor. 15:3).

Duhet të studiojmë me kujdes Shkrimet që flasin për këtë vdekje zëvendësuese (Rom. 5:6-8; 1 Pje. 2:24; 3:18). Shpëtimtari zuri vendin e mëkatarit. I drejti mori vendin e të padrejtit. I pafajshmi zuri vendin e fajtorit. Vdekja e Jezusit nuk ishte vetëm një shembull moral. Fajet tona e kërkonin (Rom. 4:25) dhe kjo u bë sipas këshillës së Perëndisë (Veprat 2:23). Jezusi u bë viktimë vullnetare; askush s'ia hoqi jetën (Gjo. 10:17-18). Dha vetveten për ne (Gal. 1:4), u bë mëkat për ne (2 Kor. 5:21; Gal. 3:13). Në këtë mënyrë na ka blerë Jezusi, na ka çliruar (1 Pje. 1:18-19; Mt. 20:28). Ai ka bërë paqen nëpërmjet gjakut të kryqit (Kol. 1:20). Mëkatarit është justifikuar, ose është deklaruar i drejtë, dhe është pajtuar me Perëndinë nëpërmjet vdekjes së Jezusit (Rom. 5:9-10).

**Përsosmëria e sakrificës**

Sakrifica është një fjalë e përdorur në mënyrë të përsëritur në Bibël dhe është në qendër të mesazhit të krishterë. Vdekja shlyese e Zotit Jezus mund të konsiderohet në mënyrë të ndryshme.

1. SAKRIFICA E GJAKUT (Heb. 9:22). Pa derdhje gjaku nuk ka falje të mëkateve.

2. SAKRIFICE NJERËZORE (Heb. 9:12-14; 10:4). Vetëm një njeri mund të vdesë në vend të një njeriu tjetër për të



kënaqur drejtësinë e Perëndisë.

3. SAKRIFICË PA MËKAT (Heb. 4:15; 1 Pje. 1:19; Gjo. 8:29,46). Veç i Vetmi pa mëkat mund të vdesë për mëkatet e të tjerëve.

4. SAKRIFICE HYJNORE (Heb. 1:1-3; Kol. 2:8-9; 2 Kor. 5:19). Ai i ka pastruar mëkatet tona. Askush, përveç Perëndisë, s'mund ta bëjë këtë (Isa. 43:25).

5. SAKRIFICE DASHURIE (Efes. 5:25; Zbu. 1:5). Kryqi është shprehja themelore e dashurisë së Perëndisë për njerëzit mëkatar.

6. SAKRIFICE E MJAFTUESHME (1 Gjo. 2:2; Heb. 10:14). Ai ka kënaqur plotësisht dhe përfundimisht gjithçka që drejtësia e përsosur e Perëndisë e kërkonte.

### **Vepra e përmbushur**

Zoti Jezus i tha Atit: «pasi kam përmbushur veprën që Ti më dhe ta bëja» (Gjo. 17:4). Thirrja e Tij finale mbi kryq ishte «U përmbush!» (Gjo. 19:30). Cila ishte vepra e madhe që kishte çuar deri në fund? «Sepse Biri i njeriut ka ardhur për të kërkuar dhe shpëtuar të humburin» (Luka 19:10). «Ati ka dërguar Birin për të qenë Shpëtimtari i botës» (1 Gjo. 4:14). Misioni i Tij ishte që të shpëtonte «popullin e Tij nga mëkatet e tyre» (Mt. 1:21). Të reflektojmë mbi atë se si Jezusi kompletoi deri në fund veprën të cilën kishte ardhur ta kryente.

1. Ka plotësuar të gjitha gjërat prej të cilave ne nuk mund të ishin të justifikuar nëpërmjet ligjit të Moisiut (Rom. 8:3-4).

2. Ka plotësuar gjithçka që ligji e kërkonte nga ne (Veprat 13:39).

3. Na ka liruar nga çdo dënim (Rom. 8:1).

4. Drejtësia dhe shenjtëria e Tij janë të kënaqura (Psalmi 85:10).

5. Vepra e Tij është e mjaftueshme për të shpëtuar të gjithë mëkatarët (1 Gjo. 2:2; Gjo. 1:29; 12:32). Por nuk mund ta bëjë n.q.s. ata nuk shkojnë tek Ai (Mt. 23:37).

6. Ai ka «ofruar një sakrificë të vetme për mëkatet dhe përgjithmonë» (Heb. 10:12). Askush nuk duhet t'i shtojë as gjënë më të vogël veprës së Tij të përmbushur mbi kryq. Ajo është baza e vetme dhe e mjaftueshme për të na liruar nga mëkatet tona.

### **Prova e aprovimit**

Predikimi i kishës primitive ishte që Perëndia e kishte ngjallur Jezusin nga të vdekurit. Dhe pikërisht në bazë të kësaj njerëzit u thirrën që të besonin tek Ai (Veprat 2:24,32; 3:15,26; 10:40).

1. U ringjall sipas Shkrimeve (1 Kor. 15:4), duke plotësuar në këtë mënyrë profecitë e parathëna rreth 1000 vjet më parë (Psa. 16:10; Veprat 13:35-37).

2. U ringjall sipas asaj që Ai vetë e kishte thënë (Mt. 12:39-40; 16:21; Luka 18:31-33). Specifikoi ditën ekzakte të ringjalljes së Tij (Mt. 27:63).

3. U ringjall megjithëse ishte një ushtar Romak që bënte roje tek varri. Ishin bërë të gjitha sforcimet për të penguar që të ndodhte një ringjalljeje e rremë (Mt. 27:63-66). E panë shumë dëshmitarë (1 Kor. 15:5-8).

4. U ringjall nga fuqia e Perëndisë dhe provoi në mënyrë bindëse që gjithçka që kishte thënë dhe bërë ishte plotësisht e aprovuar nga Perëndia (Rom. 1:3-4; Efes. 1:19-20).

5. U ringjall sepse ringjallja e Tij ishte thelbësore për justifikimin tonë (Rom. 4:25).

Madhështia e veprës së Tij nuk e heq nevojën e një përgjigjeje nga ana e njeriut. Të gjithë njerëzit nuk janë të shpëtuar automatikisht, gjithsecili prej tyre duhet që personalisht të vendosi të pranojë ose jo veprën e përmbushur nga Krishti.

### **Pyetje - Mësimi 8**

Shumë persona pohojnë se besojnë që Jezusi vdiq mbi kryq për mëkatet e njerëzve, por në realitet nuk e kuptojnë këtë. Me një sjellje lutjeje, konsidero sa ke kuptuar nga kjo e vërtetë e madhe, duke iu përgjigjur sa vijon:

1. Jezusi vdiq mbi kryq sepse (zgjidh një përgjigje)

- a. ishte viktimë e rrethanave
- b. ishte viktimë e një gabimi tragjik
- c. mëkati duhej të gjykohej që të mund të shkonim tek Perëndia
- d. nuk mund t'i ikte as Romakëve dhe as udhëheqësve Çifutë

2. Jezusi mund t'i lirojë mëkatarët nga dënimi me vdekje (zgjidh një përgjigje)

- a. duke i bërë veprat e mira ose veprat fetare
- b. duke kaluar sipër mëkateve të tyre pikërisht për dashurinë e Tij
- c. duke parashikuar një sakrificë të përkryer për mëkatin
- d. duke bërë çfarëdo lloj gjëje që i pëlqen sepse Ai është Perëndi

3. N.q.s. Jezusi nuk do të kishte vdekur mbi kryq (zgjidh një mundësi)

- a. do të ishim të humbur përgjithmonë dhe pa shpresë
- b. do të na tregojë një mënyrë tjetër, e pranueshme, për të shkuar tek Perëndia
- c. do të ishim të detyruar të punonim dhe të lodheshim më shumë që t'i pëlqenim Perëndisë
- d. do të pranoheshim në planin e dashurisë së Tij

4. Shkruaj me fjalët e tua 1 Pje 3:18 ose Isa. 53:4-5.

5. N.q.s. Perëndia e donte shumë Birin e Tij, përse ka lejuar që Ai të vuante dhe të vdiste në kryq (Rom. 4:25; 5:6-8)?

6. Për kë vdiq Jezusi (Gjo 3:16; 1 Gjo 2:2)?

7. Çfarë dëshironte të thoshte Jezusi kur tha «U krye» (Gjo. 19:30)?

8. Jep një provë bindëse për ringjalljen e Jezu Krishtit.

9. Çfarë mendon? Shpjego me fjalët e tua arsyen e vdekjes së Jezusit mbi kryq.

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet që vijojnë:

(1) Sipas jush, cili ishte shkaku i vdekjes së Jezu Krishtit mbi kryq?

(2) Besoni që Jezusi u ringjall nga varri dhe është i gjallë sot?

(3) Çfarë efektesh duhet të ketë në jetën e një personi besimi në ringjalljen e Jezu Krishtit?

## LINDJA E RE

«N.Q.S. NJË NJERI NUK LIND PËRSËRI, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë» (Gjo. 3:3). Një personi që besonte tek Perëndia, një fetar, që me devotshmëri shkonte në sinagogë, një person me cilësi morale të mrekullueshme, që shkoi për ta nderuar, Jezusi i drejtoi këto fjalë solemne. Të gjitha ato që Nikodemi kishte ishin të pamjaftueshme që të përgatisnin takimin e përjetshme me Perëndinë. Je ti i përgatitur të takosh Perëndinë?

**Çfarë do të thotë të lindësh përsëri?**

Të kesh lindur sërish do të thotë të jesh rigjeneruar (të kesh marrë një jetë të re). Kur Jezusi i tha Nikodemit që ishte e nevojshme që ai të lindte përsëri, nuk po fliste për një lindje fizike por për një lindje shpirtërore (Gjo. 3:4-6). Jezusi u habit nga fakti që Nikodemi, i cili i mësonte popullit ligjin, nuk e kuptoi këtë (Gjo. 3:10). Në Dhiatën e Vjetër flitej për rilindjen ose rigjenerimin e kombit të Izraelit (Eze. 36:26; 37:1-10). Rilindja e ardhshme e krijimit nga gjendja e tij e mallkuar si shkak i mëkatit, ishte një mësim që dihej (Mt. 19:28). Nikodemi nuk e kishte kuptuar që lindja e re ishte një shprehje që përdorej për individin në momentin në të cilin ai hynte për të bërë pjesë në familjen e Perëndisë.

Lindja e re është një ngjarje personale. Është një jetë e re, një lloj i ri marrëdhëniesh familjare, një fuqi e re e brendshme. Bibla thotë që ne hyjmë në mbretërinë e qiejve në të njëjtën mënyrë të atij që kalon nga vdekja në jetë (Gjo. 5:24). N.q.s. më parë ecim në errësirë, tani ecim në dritë (Gjo. 8:12). Kalojmë nga mbretëria e Satanit në mbretërinë e Birit të Perëndisë (Kol. 1:13). Jemi një krijim i ri (2 Kor. 5:17). Ky krijim i ri bëhet në drejtësi, në shenjtëri dhe në vërtetësi (Efes. 4:24).

**Përse njeriu natyror duhet të lindë përsëri?**

Shprehja «njeri natyror» i referohet individit që lind dhe jeton në mish përpara se të marri jetën e re nga Perëndia.

1. ËSHTË I SHTHURUR (Zanafilla 8:21). Ka një zemër mashtruese (Jeremia 17:9). Në mishin e tij nuk gjendet asgjë e mirë (Rom. 7:18).
2. ËSHTË I VDEKUR NË MËKATE (Efes. 2:1). Sipas metrit të Perëndisë, nuk ka te njeriu asnjë lloj jete shpirtërore.
3. ËSHTË I KONTROLLUAR NGA SATANI (Efes. 2:2).
4. ËSHTË ARMIK I PERËNDISË (Rom. 5:10). Njeriu natyror është pa shpresë dhe pa Perëndinë në botë (Efes. 2:12).

Çdo bir i Perëndisë ndodhej një herë në këto kushte.

**Në çfarë mënyrë një njeri mund të lindë përsëri?**

**1. DY ILUSTRIME PER LINDJEN E RE.** Në një studim të kujdesshëm të Gjonit 3 nuk do të gjendet asnjë mbështetje për idetë e pjesës më të madhe të njerëzve për sa i përket mënyrës për të hyrë në mbretërinë e qiejve. Jezusi nuk përmendi asnjëherë veprat e mira, përkrahjen e organizatave fetare ose marrjen pjesë në ceremoni fetare. Jep, në fakt, dy ilustrime për të shpjeguar lindjen e re:

a. Erën (Gjo. 3:8). Është e padukshme, e paparashikueshme në aktivitetin e saj dhe megjithatë e dukshme në efektet e saj. Burimi është Perëndia dhe jo njeriu. Lindja e re gjen burimin e saj tek Perëndia (Gjo. 1:13). Dërgohet nga Ai për të punuar në mënyrë të padukshme dhe të fuqishme, duke ndryshuar jetët.

b. Gjarpri i bakrit (Gjo. 3:14-15; Numrat 21:6-9). Kur populli mëkatoi, Perëndia i tha Moisiut të prodhonte një gjarpër prej bakri dhe ta vendoste mbi një shtyllë. Të gjithë ata që, duke besuar atë që Moisiu kishte thënë, shikonin objektin e providencës së Perëndisë shëroheshin. Jezusi, Biri i njeriut, tha që Ai vetë do të «ngrihej» si gjarpri mbi shtyllë, për të qenë objekt i besimit shpëtues. Ishte e qartë që kjo «ngritje» i referohej kryqit (Gjo. 12:32-33). Lindja e re fillon kur ne shikojmë Jezusin të kryqëzuar për mëkatet tona.

## **2. DY FAKTORE VENDIMTARE NË LINDJEN E RE.**

a. Fjala e Perëndisë (1 Pje. 1:23; Jak. 1:18). Ne dëgjojmë Fjalën e së Vërtetës dhe besojmë te ajo për t'u shpëtuar (Efes. 1:13; Rom. 10:17). Ajo është fara e shpëtimit (Mt. 13:3-9; 18-23). Lindja e re është kur besojmë me të vërtetë Fjalën e Perëndisë dhe i bindemi asaj.

b. Fryma e Shenjtë (Titi 3:5; Gjo. 3:5,6,8). Ai i bind njerëzit për mëkatën (Gjo. 16:8-11) dhe i udhëheq tek Krishti. Lindja e re është vepër e Frymës së Shenjtë. Një vepër e tillë fillon me bindjen për mëkatën dhe të çon në një jetë të pastruar, «larja e rilindjes».

Vërehet që gjithë ajo që thamë më lart s'ka të bëjë me pagëzimin në ujë. Në fakt, pagëzimi nuk përmendet. Uji në Bibël përdoret si simbol i Frymës (Gjo. 7:38-39) dhe i Fjalës (Efes. 5:26). Pagëzimi nuk ka asgjë të përbashkët me ilustrimet e përdorura nga Jezusi të erës dhe të gjarprit prej bakri. Është një portret i shpëtimit. Pagëzimi është shumë i rëndësishëm, por vjen pas lindjes së re, nuk e prodhon ai lindjen e re (Veprat 8:12-13; 37-38).

### **Cilat janë rezultatet e lindjes së re?**

1. Kemi një zemër dhe një shpirt të ri (Eze. 11:19).
2. Jemi pjesëtarë të natyrës hyjnore (2 Pje. 1:4).
3. Fryma e Perëndisë banon tek ne (Rom. 8:9).
4. Jemi bij të familjes së Perëndisë (1 Gjo. 3:1).
5. Kemi jetën e përjetshme (1 Gjo. 5:11-12).
6. Duam Zotin Jezu Krisht (1 Gjo. 5:1).
7. Duam të tjerët, në veçanti besimtarët (1 Gjo. 3:14; 4:7).
8. Dëshirojmë t'i bindemi Zotit Jezus (1 Gjo. 2:3).
9. Nuk bëjmë mëkat (1 Gjo. 3:9).
10. Praktikojmë drejtësinë (1 Gjo. 2:29).

Je bindur për mëkatën dhe i je drejtuar Jezu Krishtit që të shpëtohesh? Ke besuar tek Ungjilli i shpëtimit dhe e ke vendosur besimin tënd tek Krishti?

## Pyetje - Mësimi 9

Jezusi tha që askush nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë n.q.s. nuk lind përsëri. Të kuptosh këtë është themelore. Përgjigju pyetjeve të mëposhtme mbasi të kesh reflektuar me kujdes.

- Përgjigju duke nënvizuar e vërtetë ose e gabuar.
  - Një person lindet përsëri kur pagëzohet në ujë. (E Vërtetë ose E Gabuar)
  - Dy ilustrimet e lindjes së re të formuara nga Jezusi janë deti dhe gjarpri i bronzë. (E Vërtetë ose E Gabuar)
  - «Të lindësh sërish» është një shprehje që përdoret kryesisht për një ndryshim feje. (E Vërtetë ose E Gabuar)
- Nikodemi, në një moment të parë, shkoi tek Jezusi (zgjidh një përgjigje)
  - si besimtar i Perëndisë
  - si njeri i virtytshëm
  - si frekuentues i sinagogës
  - sepse i interesonte Jezusi
  - të gjitha përgjigjet e mësipërme
- «I lindur sërish» do të thotë (zgjidh një përgjigje)
  - të bësh pjesë në kishë
  - të ndryshosh fenë tënde
  - të kesh një jetë të re që vjen nga Perëndia
  - një ndryshim gradual shpirtëror
  - të besosh tek Perëndia
- Njeriu natyror duhet të lindë përsëri sepse (zgjidh një përgjigje)
  - është i korruptuar
  - është i vdekur në mëkat
  - është i dominuar nga Satani
  - është armik i Perëndisë
  - për të gjitha përgjigjet e mësipërme
- Shkruaj me fjalët e tua Gjonin 1:12-13.
- Cili është roli i Fjalës së Perëndisë në lindjen e re (Mateu 13:3-9, 18-23; Rom. 10:17; Efes. 1:13; 1 Pje. 1:23)?
- Cili është roli i Frymës së Shenjtë në lindjen e re (Gjo. 3:6-8; 16:7-11; Titi 3:5; Veprat 2:37)?
- Cilat janë rezultatet e lindjes së re?
- Çfarë mendon? Shpjego me fjalët e tua «lindjen e re».
- Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre persona gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

- (1) Shumë njerëz përdorin sot shprehjen «lindje e re». Çfarë do të thotë për ju kjo shprehje?
- (2) Sipas jush, në çfarë mënyrë një njeri bëhet pjesëtar i familjes së Perëndisë?
- (3) Për çfarë arsye, sipas jush, Jezusi ka përdorur këtë shprehje për të përshkruar çfarë do të thotë të jesh i shpëtuar?

## SHPËTIMI NËPËRMJET HIRIT

«SEPSE JENI TË SHPËTUAR PREJ HIRIT, nëpërmjet besimit; dhe kjo nuk është prej jush; është dhuratë e Perëndisë. Nuk është si rezultat i veprave që askush të mos lavdërohet» (Efes. 2:8-9). Shpëtimi është nëpërmjet hirit, kjo do të thotë që ai është një favor i Perëndisë i pamërituar; është një dhuratë dhe si e tillë nuk mund të blihet ose të fitohet. Kjo doktrinë është shumë e vështirë të pranohet nga njerëzit fetar; shpesh atje pranohet në mënyrë parciale ose në një farë mënyre që mohon të vërtetën e saj.

Fjala e përdorur në Dhiatën e Vjetër «prej hirit» do të thotë «të ulësh duke treguar dashamirësi ndaj një vartësie». Ky është përshkrimi i saktë i asaj që Perëndia ka bërë drejt nesh. Falja në Dhiatën e Re, do të thotë «favor, zemërgjerësi pa interes, mirësi drejt dikujt, dhuratë». Kjo tregon që shpëtimi nuk fitohet, nuk meritohet, nuk blihet, as e gjitha dhe as pjesërisht. Shpëtimi tek Krishti është «dhuratë e Perëndisë» dhe nuk kërkon asnjë pagesë për Dhuruesin.

### Ide të gabuara për hirin

Arsyeja njerëzore e shtyn njeriun të mendojë që veprime të caktuara të ndihmojnë për të fituar përpara Perëndisë merita për shpëtim. Konsidero pohimet e mëposhtme nën dritën e asaj që Fjala e Perëndisë thotë për sa i përket koncepteve të tilla:

1. VEPRA: NJË MËNYRE PËR TË ARRITUR TEK PERËNDIA. «Por n.q.s. është nëpërmjet hirit, nuk është më nëpërmjet veprave» (Rom. 11:6). «Ai na ka shpëtuar jo nëpërmjet veprave të drejta që ne kemi bërë, por sipas mëshirës së Tij» (Tit 3:5). Ai që kërkon të fitojë favore për shpëtim nëpërmjet veprave njerëzore kërkon ta bëjë Perëndinë borxhli (Rom. 4:4).

2. ZBATIMI I DHJETË URDHRAVE. «Askush nuk bëri gjithçka që kërkon Ligji. Prandaj askush nuk mund të dalë i pafajshëm me anë të zbatimit të Ligjit. Në të vërtetë, me anë të Ligjit demaskohet fuqia e mëkatit që vepron në ne» (Rom. 3:20). «Ju që kërkonti të merrni pafajësinë me zbatimin e Ligjit, i shkëputët marrëdhëniet me Mesian; morët më kot mëshirën e Perëndisë» (Gal. 5:4). Kontrasti shikohet tek Gjoni 1:17: «Me anë të Moisiut Perëndia na dha Ligjin, por me anë të Jezusit, Mesias, Perëndia u takua me ne me tërë mirësinë dhe besnikërinë e Tij».

Nuk ka pra asnjë arsye që të krenohemi që i përkasim Perëndisë (Rom. 3:27); nuk mund të jetë «një shkallë drejt Perëndisë», e ndërtuar mbi drejtësinë njerëzore ose mbi veprimet fetare. Njerëzit nuk shpëtohen duke mos bërë diçka, duke bërë marrëveshje me Perëndinë, ose duke ofruar përpjekjet e tyre për të kompletuar atë që Ai e ka bërë. Shpëtimi nuk merret nëpërmjet veprave, as duke zbatuar ligjin, as me ceremoni fetare dhe as duke kërkuar që ta bëjmë Perëndinë tonë borxhli; por është nëpërmjet hirit, vetëm prej hirit.

### Përse është i nevojshëm hiri?

1. GJENDJA MORALE E NJERIUT. Ai nuk ka në veten e tij forcën që të mund të afrohet moralisht tek Perëndia (Rom. 5:6). Si mund të bënte një rrugë drejt Perëndisë?

2. SHENJTËRIA ABSOLUTE E PERËNDISË. Njeriu asnjëherë nuk do të arrinte tek Perëndia me anë të sforcimeve të tij. Shenjtëria e Perëndisë kalon me diferencë mjaft të madhe edhe më të mirën ndërmjet njerëzve (Isa. 6:3-5); por Perëndia u ul deri tek njeriu në hir.

### Cilat janë efektet e hirit?

1. JEMI TË SHPËTUAR PREJ HIRIT (Rom. 3:24; 4:16). Nuk ka shtesa nga ana e njeriut.

2. JEMI TË MBROJTUR NGA HIRI (Gjo. 10:28-29; 1 Pje 1:5; 5:10). Ai na mban në dorën e Tij dhe na mbron me



fuqinë e Tij. Nuk jemi të mbrojtur nga ligji (Gal. 3:2-3) ose nga vepra të tjera. Jemi nën hir dhe jo nën ligj (Rom. 6:14).

3. JEMI TE FORTE NE HIR (Rom. 5:2; 1 Pje. 5:12). Perëndia na trajton mbi këtë parim.

4. JETOJME NEPERMJET HIRIT (Heb. 13:21; Fil. 2:13). Është Perëndia që vepron tek ne në mënyrë që fuqizon jetën tonë të krishterë.

### **Paralajmërimi për hirin**

Nga ajo që u tha më lart asgjë nuk duhet të na autorizojë të mëkatojmë ose të zvogëlojë rëndësinë e thirrjes tonë për të jetuar në mënyrë të denjë për Perëndinë.

1. TE MOS MEKATOJME NE MENYRE QE HIRI TE SHTOHET (Rom. 6:1).

2. MOS TA KTHEJME HIRIN E PERENDISE NE NJE SHEFAJESIM PER PASTERTI (Juda 4). Liria nuk është një rast për mbrapshti por një rast për sakrifica të përzemërta (Gal. 5:13).

3. KEMI QENE TE SHPETUAR PER TE BERE VEPRA TE MIRA (Efes. 2:10; Titi 3:8). Të mos mëkatojmë (1 Gjo. 3:9). Të zbatojmë Fjalën e Perëndisë (1 Gjo. 2:3-5). Këto në fakt janë frytet e shpëtimit dhe jo mjetet për të fituar favorin e Perëndisë. Jetojmë për Perëndinë sepse duam Zotin Jezus (Gjo. 14:15, 21).

I vetmi mesazh i krishterë është Ungjilli i hirit (mëshirës) (Veprat 14:3; 20:24,32). Ky Ungjill vjen nga Perëndia me plot hir (1 Pje. 5:10), i cili na pranon në fronin e hirit (Heb. 4:16). Ky është një parim konstant i karakterit të Perëndisë dhe e mënyrës së Tij se si na trajton. Nuk duhet të afrohemi tek Ai me idenë që Perëndia na ka borxh diçka.

### **Pyetje - Mësimi 10**

Besimi Biblik është i vetmi që pohon të vërtetën e shpëtimit nëpërmjet hirit. Sisteme të tjera që kanë bërë përçapje drejt Perëndisë mohojnë plotësisht ose pjesërisht këtë të vërtetë. Sigurohu që ta kesh kuptuar mirë këtë doktrinë duke ju përgjigjur këtyre pyetjeve.

1. Të respektosh dhjetë urdhrat (zgjidh një mundësi)

- a. është themelore për shpëtimin e besimtarit
- b. do të thotë të jesh bashkuar në veprën e Krishtit mbi kryq
- c. është diçka që tashmë mund të lihet në hije plotësisht
- d. është modeli i përkryer i kërkuar për të marrë drejtësinë e Perëndisë
- e. asnjë nga përgjigjet e lart përmendura

2. Kontrolllo me kujdesin më të madh. Hiri është Perëndia

- a. që arrin ata që nuk meritojnë favorin e Tij
- b. që arrin ata që meritojnë favorin e Tij
- c. që arrin ata që meritojnë gjykimin e Tij

3. Sipas Shkrimit, të gjithë njerëzit (zgjidh një përgjigje)

- a. janë në themel të mirë
- b. kërkojnë në thelb Perëndinë
- c. janë në themel të shthurur
- d. janë në thelb të gatshëm, por të dobët

4. Perëndia mund të shpëtojë mëkatarët nëpërmjet hirit dhe të mbetet i shenjtë sepse (zgjidh një përgjigje)

- a. Krishti ka marrë vendin e mëkatarit dhe ka vuajtur për ne
- b. Perëndia mund të bëjë çfarëdo gjëje që i pëlqen, edhe jo logjike
- c. mëkati nuk është shumë i rëndë
- d. është detyrë e Tij drejt krijesës së Tij

5. Shkruaj me fjalët e tua Efes. 2:8-9.

6. Vendos në kontrast dy elementë në çdo varg të poshtë shënuar:

1 Pje. 5:5

Juda 4

Galatasve 5:4

Romakëve 11:6

Romakëve 4:4

7. Cila nga këto pohime të Biblës reflekton hirin?

- a. «Bëj këto dhe do të jetosh»
- b. «Ti do ta duash të Përjetshmin Perëndinë tënd»
- c. «Ne e duam sepse Ai na ka dashur i pari»
- d. «Shpirti që mëkaton do të jetë ai që do të vdesë»

8. Çfarë koncepti i rremë mbi hirin korrigohet tek Juda 4 dhe 1 Pje. 2:16?

9. Çfarë mendon? Shpjego me fjalët e tua çfarë domethënie ka për ty hiri i Perëndisë.

## TE BESOSH TE JEZUS KRISHTI

Roja i burgut në Filip pyeti: «Çfarë duhet të bëj për të shpëtuar?» Apostulli Pal u përgjigj: «Beso tek Zoti Jezus dhe do të shpëtosh» (Vepra 16:30-31). Por çfarë do të thotë të besosh tek Zoti Jezus?

Shumë persona kanë ide të çuditshme mbi këtë argument kaq të rëndësishëm. Ja disa shembuj të përgjithshëm dhe jo biblik: njerëzit thonë: «Unë besoj»

1. Sepse pranoj që Jezusi ka jetuar dhe ka vdekur këtu mbi tokë;
2. Sepse admirojnë moralin dhe etikën e Jezusit;
3. Sepse bëjnë pjesë në një grup fetar;
4. Sepse i luten Perëndisë;
5. Sepse kanë recituar një lutje, një afirmim doktrinor, ose ndonjë lloj formule.

Është kjo mënyra, e treguar në Bibël, që të besosh tek Jezusi? Mund të ndryshojë kjo mënyrë e të besuarit jetën e njerëzve? Të jep sigurinë solide se do të shkosh në qiell?

### Çfarë është besimi?

Çfarë do të thotë të besosh tek Krishti? Përkufizimi biblik i besimit përmbledh konceptet e besimit, të bindjes, të rrëfimit. N.q.s. themi: «Besoj tek ai person», kjo sigurisht është e kundërta e dyshimit. Nuk do të thotë të jemi sylesh. Besimi zotëron elementet e mëposhtme:

1. **BESIMI KA NJË OBJEKT.** Ajo vendoset tek dikush ose tek diçka. Për të krishterët objekti i besimit është një Person i Gjallë, Zoti Jezu Krisht (Veprat 20:21). «Kjo është vepra e Perëndisë: që të besoni tek Ai që Perëndia ka dërguar» (Gjo. 6:29). Zoti Jezus pyeti të verbrin: «Beson ti tek Biri i Perëndisë?» (Gjo. 9:35). Keqbërësi mbi kryq duhet vetëm të besonte tek Jezusi që të shkonte në parajsë (Luka 23:42-43). Kjo mënyrë besimi u bë qendra e mesazhit ungjillor (Veprat 8:35-37; 1 Gjo. 5:13). Nuk është e rëndësishme sa besojmë, por tek kush besojmë. Besimi merr (pranon) Jezusin (Gjo. 1:12).

2. **BESIMI KA NEVOJË PËR NJË PËRMBAJTJE.** Duhet të dëgjojmë Fjalën e Ungjillit dhe të besojmë tek Ai (Veprat 15:7). Korintasit u shpëtuan kur Pali i predikoi atyre Ungjillin, atë Ungjill që është «Ungjilli i plotë», përcaktuar tek 1 Kor. 15:1-4. Krishti vdiq për mëkatet tona, u varros dhe u ringjall, e gjitha kjo sipas Shkrimeve. Besimi tek Krishti vjen pas dëgjimit të Ungjillit, që quhet fjala e së vërtetës (Efes. 1:13). Ky Ungjill është aq i çmuar dhe themelor saqë kushdo që përmbys është i mallkuar, njeri ose engjëll qoftë (Gal. 1:6-9).

3. **BESIMI KA NJË BAZË.** Baza është Fjala e Perëndisë (1 Thes. 2:13; Rom. 10:17). Besimi i krishterë ka si objekt atë që është përcaktuar në Shkrim «dëshmia e Perëndisë» (1 Gjo. 5:9). Besimi pranon të vërtetën e Perëndisë (1 Thes. 2:13) dhe beson që Perëndia është i vërtetë megjithëse njerëzit janë gënjeshtarë (Rom. 3:3-4). Nuk jemi duke bërë «një hedhje në errësirë», duke ushtruar një besim të verbër, ose duke u besuar vetëm emocioneve tona. Ne besojmë tek Fjala e Perëndisë dhe mbështetemi me besim tek ajo.

4. **BESIMI PROVOKON VEPRIME.** Mbase kemi idenë që besimi është thjeshtë një aprovim mendor i disa pohimeve, por nuk është kështu. Të vërehen foljet vepruese në shprehjet e mëposhtme: njerëzit erdhën tek Jezusi, ranë përmbys para Tij dhe iu bindën fjalës së Tij; Ai i tha një njeriu që të shtrinte dorën (Mateu 12:13); i tha një tjetri që të merrte vigun e tij (Mt. 9:6); i tha një tjetri që të lahej në një vaskë (Gjo. 9:7). Vazhdimisht Jezusi kërkon veprim. Abrahami është njeriu model që besoi tek Perëndia. N.q.s. shikojmë Zan. 12:1-4, Veprat 7:2-3 dhe Heb. 11:8, do të vërehet që Abrahami dëgjoi fjalën e Perëndisë dhe iu bind duke braktisur qytetin e tij të lindjes, pa e ditur se ku do ta udhëhiqte Perëndia. Kjo përgjigje me besim demonstroi besimin e tij në mënyrë të qartë. Besimi që shpëton është një besim që prodhon veprim. Nuk ka qenë asnjëherë një pranim mendor

pasiv i fakteve historike. Një e ashtuquajtur «besim», por që nuk ka vepra, është një «besim i vdekur». Kur një njeri beson me të vërtetë tek Krishti, rezultati do të jetë domosdoshmërisht një jetë me vepra të mira. (Shiko Jakobin 2:14-26, ku besimi që shpëton dhe «besimi i vdekur» janë të kundërta). Besimi që shpëton implikon diçka më shumë se një «e besuar që» faktet për sa i përket Jezusit dhe vdekja e Tij janë të vërteta. Ne «besojmë në» Birin e Perëndisë dhe i jemi dorëzuar Atij personalisht.

### **Shembuj besimi**

Shkrimet janë të mbushura plot me shembuj besimi. Kapitulli i njëmbëdhjetë i Hebrenjve është përcaktuar «Lista e nderit e besimit», në të cilin renditen disa burra dhe gra që patën besim. Ekzaminoji dhe nxirr në pah veprimet e bërë në hapat e tyre të besimit.

Mund të përmenden edhe dy shembuj të tjerë. I pari është besimi i kapitenit, tek Mateu 8:5-10. Ky kapiten besonte që Jezusi mund ta shëronte shërbëtorin e tij vetëm duke thënë vetëm një fjalë të Tij. Shembulli tjetër është besimi i gruas kanaanease (Mt. 15:22-28). Ajo i kërkoi Jezusit që Ai të lironte vajzën e saj nga djajtë. Besimi i saj ishte i përlulur dhe këmbëngulës.

### **Si të shkosh tek Krishti**

Shkuarja tek Krishti implikon disa gjëra:

1. SHPIRTI NA KA BINDUR PER MËKATIN (Gjo 16:8-11). Pranojmë gjendjen tonë mëkatore përpara Perëndisë (Luka 15:18; 18:13-14).
2. PENDOHEMI PER MËKATET TONA. (Luka 13:3; Veprat 3:19; 17:30; 20:21). Dëshirojmë të ndryshojmë, duke i kthyer shpinën mëkateve tona dhe duke u kthyer nga Krishti.
3. NJOHIM UNGJILLIN. Duhet ta njohim dhe t'i besojmë që të shpëtohem (Veprat 15:7-9; 1 Kor. 15:1-4). Qendra e mesazhit të tij është Zoti Jezu Krishti.
4. BESOJMË NË FJALËN E PERËNDISË (Marku 4:20; Gjo. 5:24).
5. MARRIM NËPËRMJET BESIMIT BIRIN E PERËNDISË (Gjo. 1:12; 1 Gjo. 5:12-13) dhe bëhemi ndjekës së Tij (Gjo. 10:4-5,27).
6. SI RRJEDHIM, RRËFEJMË JEZUSIN PËRPARA TË TJERËVE. (Mt. 10:32; Luka 12:8; Rom. 10:9).

Besimi që shpëton e vendos të gjithë peshën e tij mbi Zotin Jezu Krisht dhe mbi veprën e përmbytur të Tij. Besimi është instrumenti, mjeti, kanali nëpërmjet të cilit rrjedh hiri i Perëndisë. Nuk është burimi i shpëtimit, nuk është një veprim i lavdërueshëm, as një çmim moral që na bën të lavdërueshëm. Është në fakt dora bosh që pranon atë që Perëndia ofron falas. Hakmarrja mbetet mbi ata që nuk i binden Ungjillit (2 Thes. 1:8) dhe zemërimi i Perëndisë mbi ata që nuk besojnë në Birin e Tij (Gjo. 3:36).

Besimi ia jep të gjithë lavdinë Perëndisë. Mund të ushtrohet nga të gjitha kategoritë e njerëzve, çfarëdo lloj moshe, pozicioni dhe shkalle zgjuarsie, dhe është në mënyrë universale i arritshëm. Besimi i rremë mund ta përmendë emrin e Krishtit, mund edhe të bëjë vepra të fuqishme, por Zoti di të heqë maskën dhe do t'i hedhë poshtë mashtruesit (Mt. 7:21-23; Luka 13:28), sepse këta janë egjra në mes të grurit (Mt. 13:24-30). Besimi autentik tregon një ndryshim jete (Heb 6:9-10). Besimtarët e vërtetë i binden Fjalës së Perëndisë (1 Gjo. 2:4-5), i duan besimtarët e tjerë (1 Gjo. 3:14), bëjnë vepra të mira (Efes. 2:10), praktikojnë drejtësinë (1 Gjo. 3:7,10; Efes. 4:22-24) dhe nuk bëjnë mëkat (1 Gjo. 3:9-10; Gal. 5:19-21).

A ke besuar ti tek Zoti Jezu Krisht?

### **Pyetje - Mësimi 11**

Për çdo qenie njerëzore, tema më e rëndësishme i përket kohës dhe përjetësisë dhe rrotullohet rreth dy pikëpyetjeve: do të jemi gjithmonë me Perëndinë? Apo do të jemi përjetësisht të ndarë nga Perëndia?

1. Mund të jem i sigurt që kam shpëtuar sepse (zgjidh një përgjigje)

- a. jam lutur duke i kërkuar Jezusit që të hyjë në zemrën time
- b. Perëndia i është përgjigjur shumë lutjeve të mia
- c. e kam lënë mënyrën e vjetër të të jetuarit
- d. tani lexoj Biblën dhe shkoj në mbledhjet e asamblesë
- e. asnjëra prej përgjigjeve të lartpërmendura

2. Besimi që shpëton është (zgjidh një mundësi)

- a. të pranosh atë që thotë Bibla
- b. të besosh tek Perëndia me gjithë zemrën tënde
- c. të besosh që gjërat shpirtërore dhe fetare janë themelore
- d. të besosh që Jezusi jetoi dhe vdiq dhe që u bë personazhi më i madh i historisë
- e. asnjëra prej përgjigjeve të lartpërmendura

3. Përcakto me fjalët e tua besimin që shpëton.

4. Çfarë besoi «keqberësi i mirë» (Luka 23:39-43)?

5. Radhit tri pikat bazë të Ungjillit, sipas 1 Kor. 15:1-4, duke shënuar me një X atë që është për ty më e vështira për t'u besuar.

- a.
- b.
- c.

6. Shkruaj me fjalët e tua 1 Gjonin 5:9-13. E pranon plotësisht këtë dëshmi? Shpjego.

7. Cila u bë prova e besimit të vërtetë për gruan kanaanease, tek Mt. 15:22-28? Do të kishe të njëjtën sjellje përpara Zotit Jezu Krisht?

8. Në çfarë mënyre ke eksperimentuar vargjet e mëposhtme, ose ke vepruar konform tyre?

Luka 13:3

Luka 18:13-14

Gjo. 16:7-9

Gjo. 1:12

Romakëve 10:9-10

Efes. 1:13

Zbu. 3:20

9. Çfarë mendon? Në cilat pika ke akoma dyshime, për sa i përket domethënies që të besosh tek Jezusi?

N.q.s. ti do të vdesësh sot dhe do të dalësh përpara Perëndisë, dhe Ai të të pyesë: «Përse duhet të të lejoj të hyjsh në parajsë?», çfarë do të thuash?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tri vetë gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

- (1) Dëgjohet shpesh përreth shprehja «besoj tek Krishti». Mendoni që «të besosh» tek Krishti do të thotë diçka më shumë sesa thjeshtë pranimi mendor i disa fakteve që i përkasin Atij dhe jetës së Tij?
- (2) Çfarë do të thotë sipas jush që të besosh me të vërtetë?
- (3) Besoni se është e mundur për njerëzit që të kenë besim tek Perëndia për problemet ditore dhe të mos kenë për ekzistimin e tyre të përjetshëm të ardhshëm?

## SIGURIA E SHPETIMIT

Dikush ka thënë: «Askush nuk mund ta dijë me siguri n.q.s. do të shkojë në qiell». Ky pohim gjen mbështetjen e shumë kundërshtimeve. Shpesh thuhet që disa gjëra që ne bëjmë në jetë mund të na bëjnë që të humbim shpëtimin. Mbi çfarë baze mund të dimë që zotërojmë jetën e përjetshme? Kjo pyetje mund të gjejë përgjigje vetëm në pohimet e Shkrimit të Shenjtë.

**Mundësi për siguri**

«Unë ju shkrova këto gjëra që ta dini se keni jetën e përjetshme, ju që besoni në emrin e Birit të Perëndisë» (1 Gjo. 5:13). Shikohet që vargu nuk thotë që ju mund ta ndjeni - të shpresoni - ta mendoni - ose ta imagjinoni. Në fakt thotë «ta dini që keni jetën e përjetshme». Më shumë se 30 herë në letrën e tij të parë, Gjoni përdor foljen «të dish» në format e ndryshme të saj. Të shikojmë këto shprehje: «dimë që e kemi njohur» (2:3), «e dimë që kemi kaluar nga vdekja në jetë» (3:14), «e dimë që Ai banon tek ne» (3:24), «do të dimë që jemi në të vërtetën» (3:19), «e dimë që banojmë tek Ai» (4:13).

Është padyshim e vërtetë që «jo kushdo që më thotë: Zot, Zot, do të hyjë në mbretërinë e qiejve» (Mt. 7:21). Nga ana tjetër, disa që thonë se janë të krishterë dhe që i janë bashkuar disa të krishterëve Zoti do t'i përzërë (Luka 13:25-27). «Ju do t'i njihni nga frytet e tyre», thotë Shpëtimtari (Mt. 7:20). N.q.s. ka ndodhur një rilindje shpirtërore e vulosur nga Fryma e Shenjtë (Efes. 1:13), dhe e nxjerrë në pah nga jeta e personit (1 Gjo. 2:6), një besimtar, që tani mund të jetë i sigurt për jetën e përjetshme (2 Tim. 1:12; Rom. 8:38-39).

Përkufizimi i sigurisë është «besim» ose «bindje e qëndrueshme». Siguria e shpëtimit është besimi ose bindja e qëndrueshme që një besimtar ka rreth shpëtimit të tij (jetës së përjetshme). Shkrimet tregojnë me qartësi që Perëndia dëshiron që besimtari ta dijë që do të shkojë në qiell. Siguria e shpëtimit nuk është thjeshtë optimizëm njerëzor ose paragjykim. Është një fakt i bazuar mbi dëshmi të drejtë (hyjnore), e cila shpall që jemi në një marrëdhënie të drejtë me Perëndinë.

**Tre dëshmi për sigurinë e besimtarit**

Perëndia i ka dhënë të krishterit tre dëshmi që provojnë marrëdhënien e tij me Perëndinë dhe mbi të cilat ai duhet të bazojë sigurinë e tij:

1. FJALA E PERËNDISË. Kjo është dëshmia jonë më e fortë. Pikërisht sepse shpëtimi ynë bazohet mbi besimin tonë në Fjalën e Perëndisë (Zan. 15:6; Rom. 10:9-10), kështu edhe siguria jonë bazohet mbi të. Kush beson tek Biri ka jetë të përjetshme (Gjo. 3:16,36; 5:24). Shpëtimi ynë bazohet mbi faktin që ne kemi Birin e Perëndisë dhe jo mbi disa ndjenja (1 Gjo. 5:12). Në asnjë pjesë të Shkrimit nuk flitet që «të ndjehesh» i shpëtuar. N.q.s. shkojmë tek Jezusi, kemi fjalën e Tij që Ai nuk do të na përzërë (Gjo. 6:37).

2. PROVAT OBJEKTIVE TË REALITETIT. Një dëshmi tjetër e rëndësishme është realiteti i një jete të ndryshuar. Keqbërësi mbi kryq pati një mundësi të kufizuar për të dëshmuar për Krishtin, por rrëfeu publikisht besimin e tij dhe qortoi edhe keqbërësin tjetër (Luka 23:40-43). Megjithëse ka besimtarë që jetojnë një jetë mishore (1 Kor. 3:1-4), ku Loti është shembulli tipik (2 Pje. 2:7-8); kjo nuk do të thotë që jetët e tyre nuk tregojnë asnjë provë të jetës shpirtërore. Rënia njerëzore ka një zgjidhje në Shkrim (1 Gjo. 1:9; 2:1-2), por kjo nuk jep lejen të mëkatosh. Këto që pasojnë janë provat e shkruara të jetës hyjnore të individit:

- a. Rrëfimi i Krishtit (Rom. 10:9-10)
- b. Veprat e mira (Jak 2:14-26; Efes. 2:10)
- c. Bindje ndaj Fjalës së Perëndisë (1 Gjo. 2:4-5; 5:2-3)
- d. Që të mos ta duash botën (1 Gjo. 2:15)
- e. Të praktikosh drejtësinë (1 Gjo 3:7,10)
- f. Të mos praktikosh mëkatin (1 Gjo. 3:9-10; Gal. 5:21)
- g. Dashuri për vëllezërit (1 Gjo. 3:14)
- h. Pohimi i hyjnisë së Krishtit (2 Gjo. 9)

i. Vullneti për ta pranuar dhe rrëfyer mëkatin, si besimtar (1 Gjo. 1:8-9)

3. DËSHMIA E BRENDSHME. Dëshmia e tretë ka të bëjë me ndjenjat tona. Është më e dobëta nga të treja për atë që është subjektive dhe për këtë shpesh mund të na gënjejë. Megjithatë, duke u bashkuar me dy të tjerat është një dëshmi domethënëse. Këto që pasojnë janë provat subjektive e realitetit të jetës hyjnore:

- a. Dëshmia e Frymës me frymën tonë (Rom. 8:16)
- b. Nuk mbahet më mëkati si një borxh i pa paguar (Heb. 10:2)
- c. Provojmë ngashërim kur mëkatojmë (Psalmi 32:3-5)
- d. Mënyra e të jetuarit tonë ka ndryshuar (shiko provat objektive); kuptojmë realitetin e lutjes; kemi interesim për ata që humbasin; kemi dëshirën që të studiojmë Fjalën e Perëndisë etj.

### **Besimtarë të pasigurt dhe jobesimtarë që shesin mend përballë tyre**

Megjithëse dyshimet që kanë të bëjnë me shpëtimin tonë janë disa herë serioze (dhe të mëkatshme), pjesa më e madhe e besimtarëve, herët ose vonë, pushtohet nga tmerrri i këtyre dyshimeve gjatë eksperiencës së tyre të krishterë. Këto shënime që vijojnë mund të jenë një ndihmë e vlefshme për ata që kanë dyshime mbi shpëtimin e tyre:

#### Besimtarë të pasigurt

1. Janë të preokupuar për raportin e tyre me Perëndinë.

2. Tregojnë shpesh që janë vazhdimisht të preokupuar për shpëtimin e tyre.

3. Identifikohen me besimtarët megjithëse shpesh nuk ndjehen të denjë të jenë një me ta.

4. Kanë dyshime mbi shpëtimin e tyre gjatë periudhave mendore, se kanë nevojë për ndihmë në fizike dhe shpirtërore «bazë», d.m.th. në periudhat e vështira të jetës së tij.

#### Jo besimtarë që shesin mend

1. Janë të sigurt, megjithëse nuk kujdesen dhe s'kanë shumë realitet

2. Pohojnë me forcë shpëtimin e tyre, megjithëse jeta e tyre tregon të kundërtën. Janë mos-përfillësh dhe me mangësi në çdo pyetje për sa i përket këtij argumenti.

3. Kritikojnë shpesh kishën dhe besimtarët, i tallin për gjëra të ndryshme, shpesh duke përdorur një gjuhë të ashpër.

4. Tregojnë që nuk pranojnë e tyre gjatë periudhave mendore, se kanë nevojë për ndihmë në periudha të tilla kritike.

### **Të kesh të bësh me dyshimet**

1. TË NJOHËSH DYSHIMET. Mund të kesh pasur dyshime të njëjta si këto: «Kur e kam pranuar Krishtin nuk ka ndodhur asgjë - nuk e kam ndjerë veten ndryshe». «Nuk e di se kam besuar në mënyrë të drejtë». «Nuk kam dëshminë e Frymës». «Besoj se kam bërë mëkatin e pafalshëm». «Jeta ime nuk demonstroi që unë jam një besimtar. Kam falimentuar në mënyrë të mjerë».

2. EKZAMINO VETEN TËNDE. Pyetjet e mëposhtme mund të të ndihmojnë, të përcaktojnë gjendjen tënde të vërtetë shpirtërore: «Ke qenë ndonjëherë i bindur për mëkatin në jetën tënde?» «Mbi çfarë gjëje po i mbështet shpresat e tua për të shkuar në qiell?» «Kur dhe në çfarë rrethanash e ke pranuar Krishtin?» Një besimtarë i vërtetë është bindur për mëkatin dhe ka provuar pendimin, dhe po e bazon shpresën e tij vetëm mbi Krishtin dhe mbi veprën e tij. Në përgjithësi, është në gjendje të përcaktojë momentin e saktë në të cilin i është besuar



Jezu Krishtit si Zotit dhe Shpëtimtarit të tij; n.q.s. pastaj nuk di kohën e saktë, të paktën duhet të dijë që ky dorëzim ka ndodhur.

3. PËRFORCIMI I LUTJES. N.q.s. ke dyshime, bëj një lutje në të cilën i dorëzohesh Jezu Krishtit, duke e njohur si Zot dhe Shpëtimtar. Përsërite këtë lloj lutjeje, megjithatë, nuk duhet të zëvendësojë pikën thelbësore që është besimi në Fjalën e Perëndisë dhe mbështetje me besim tek ajo, të jetë më shumë një dorëzim i ndjenjave.

### Vlera e vetëvlerësimit

Jezusi vinte në ruajtje kundër vetëmashtrimit për sa i përket shpëtimit. Shumë do të deklarojnë që e kanë njohur, që kanë bërë shumë për Të duke i shërbyer, e megjithatë do të hidhen në errësirë sepse nuk kanë besuar tek Ai (Mt. 7:21-23; Luka 13:23-28). Kështu, n.q.s. do të kemi ndonjëherë ndonjë dyshim, duhet të kontrollojmë veten tonë për të shikuar n.q.s. jemi apo jo në besim (2 Kor. 13:5), duke përdorur provat objektive të realitetit që janë dhënë më lart. N.q.s. mbas kësaj do të jesh akoma në dyshime, atëherë do të jetë momenti i duhur që të deklarojsh përsëri në lutje që i dorëzohesh Krishtit duke e pranuar si Zot dhe Shpëtimtar.

### Pyetje - Mësimi 12

Mbasi e ke njohur Perëndinë, gjëja më e mirë është të kesh sigurinë që je i Tiji përgjithmonë. Por si mund ta dimë me siguri që kemi jetën e përjetshme? Shiko me vëmendje pyetjet e mëposhtme:

1. Cila prej pohimeve të mëposhtme reflekton më mirë konceptin biblik të sigurisë së shpëtimit?
  - a. Mendoj se e kam jetën e përjetshme
  - b. Shpresoj se e kam jetën e përjetshme
  - c. E di që e kam jetën e përjetshme
  - d. Mbasi vdekjes do të zbuloj n.q.s. e kam pasur jetën e përjetshme
2. Përgjigju duke nënvizuar E VËRTETË ose E GABUAR.
  - a. Është e pamundur për një njeri që të dijë me siguri që ka jetën e përjetshme. (E VËRTETË - E GABUAR)
  - b. Është e mundur të kesh sigurinë duke u bazuar mbi arsye të rreme. (E VËRTETË - E GABUAR)
  - c. Disa, të cilët thonë që besojnë, do të jenë të humbur. (E VËRTETË - E GABUAR)
  - d. Siguria e shpëtimit është thjeshtë optimizëm dhe paragjykim njerëzor (E VËRTETË - E GABUAR)
3. Shkruaj me fjalët e tua 1 Gjonit 5:10-13.
4. Çfarë tregojnë vargjet e mëposhtme përreth aftësisë të një personi për të ditur që është në zotërim të jetës së përjetshme?

1 Gjo. 2:3

1 Gjo. 3:14

1 Gjo. 3:19

1 Gjo. 3:24

1 Gjo. 4:13

5. Cilat janë dëshmitë më të mira të realitetit të raportit tonë me Perëndinë? Rreshtoji sipas radhës së rëndësisë, duke u nisur nga më e besueshmja.

- a. Dëshmia e miqve
- b. Fjala e Perëndisë
- c. Provat objektive të realitetit
- d. Dëshmia e brendshme

6. Sipas Mateut 7:21-23, përse është e rëndësishme që siguria e shpëtimit tonë të jetë e themeluar mbi baza solide?

7. Cilat nga provat objektive të realitetit, të paraqitura në mësim, janë të vërteta në jetën tënde?

8. Ke pasur ndonjëherë dyshime mbi fatin tënd të përjetshëm që kur ke pranuar Krishtin si Shpëtimtarin dhe Zotin tënd? Si ke reaguar?

9. Çfarë mendon? N.q.s. dikush do të pyesë: «Si e di me siguri që ke jetën e përjetshme?» si do t'i përgjigjesh?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre vetë gjatë kësaj jave dhe bëji atyre këto pyetje:

(1) Besoni që mund të jetë e mundur për një person të dijë me siguri që ka jetën e përjetshme?

(2) Sipas jush, çfarë nënkuptonte apostulli Gjon kur shkruante: «Unë jua kam shkruar këto gjëra që ta dini se keni jetën e përjetshme, ju që besoni në emrin e Birit të Perëndisë»? (1 Gjo. 5:13).

(3) Keni arritur ndonjëherë, në eksperiencën tuaj shpirtërore, në pikën në të cilën keni pasur sigurinë që të keni patur jetën e përjetshme?

## TË JETOSH JETËN E RE

«UNË KAM ARDHUR QË TA KENË JETËN dhe ta kenë me bollëk» (Gjo. 10:10b). «Kush beson tek Unë, siç ka thënë Shkrimi, lumenj me ujë të gjallë do të burojnë nga zemra e tij» (Gjo. 7:38). «Sepse gjithë ajo që ka lindur nga Perëndia e mund botën» (1 Gjo. 5:4). Këto deklarata të hatashme mbi jetën e kujtdo që beson tek Zoti Jezus janë paraqitur në Dhiatën e Re në mënyrën më të prerë, si normë e jetës së krishterë. Paqja, qetësia dhe fuqia shpirtërore nuk duhet të jenë gjëra të jashtëzakonshme ndërmjet ndjekësve të Shpëtimtarit, por të jetë eksperiencia normale e secilit prej tyre. Zoti nuk ofron vetëm faljen për fajin e mëkateve dhe sigurinë e jetës së përjetshme, por ofron edhe një jetë në të cilën Fryma e Krishtit vepron aktivisht për të transformuar mënyrën tonë të të vepruarit dhe për të rinovuar mendjet tona. Mund të kemi këtë lloj jetë n.q.s. i kushtojmë vëmendje asaj që na thotë Shkrimi mbi atë se si duhet jetuar. Bekimi dhe fuqia nuk janë automatike për besimtarët; varen nga disa kushte.

### Një fjalë për besimtarin e ri

Kemi parë nevojën që të jemi të sigurt se e zotërojmë jetën e përjetshme nëpërmjet Jezu Krishtit Zotit tonë. Është e rëndësishme të fiksojmë shpresat tona mbi premtimet e qarta të Fjalës së Perëndisë që janë të lidhura me vetë Atë. Është e rëndësishme edhe të manifestosh një jetë të ndryshuar si provë e realitetit e njohjes sonë të Jezu Krishtit. Ja disa inkurajime fillestare:

1. RRËFEJE KRISHTIN SI ZOTIN TËND PËRPARA TË TJERËVE (Rom. 10:9-10; Luka 12:8). Refuzo të jesh një besimtar i heshtur dhe që fshihet.
2. LER ZAKONET DHE MIQËSITË E DËMSHME (Psa. 1; 2 Kor.6:14-18). Mos lejo që të tjerët të shkatërrojnë ndërsa po përpiqesh t'i ndihmosh.
3. KËRKO NJË PERSON TË PJEKUR ME TË CILIN TË LUTESH, DIKË QË TË NDIHMOJË (Pred. 4:9-10). Ka më shumë progres dhe inkurajim me këtë lloj ndihme.

### Parime të jetës shpirtërore

Jeta e krishterë fitimtare nuk është vetëm për misionarë ose për dishepujt e jashtëzakonshëm. Është vullneti i Perëndisë për tërë popullin e Tij (2 Kor. 2:14; Efes. 4:13). Vërejtjet e mëposhtme shënojnë çdo ditë rrugën e triumfit:

1. NËNSHTRIM I PËRDITSHËM NDAJ Jezu KRISHTIT SI ZOT (Kol. 2:6; 2 Kor. 8:5). Ai nuk mund të bekojë atë që refuzon të gjunjëzohet përpara madhësisë së Tij dhe dashurisë së Tij. I përkasim Atij dhe jo vetes tonë (1 Kor. 6:19-20).
2. DORËZIM TË PËRDITSHËM NDAJ NXITJEVE TË SHPIRITIT TË SHENJTË (Rom. 6:13-19; 8:14). Nuk duhet ta trishtojmë, ta shuajmë apo t'i rezistojmë në ndonjë farë mënyrë, Atë që banon tek ne dhe na ka shuguruar (Rom. 8:9; 1 Gjo. 2:27). Duhet të jemi vazhdimisht të mbushur plot, ose të kontrolluar, nga Fryma (Efes. 5:18). Një besimtar i mbushur plot nga Fryma ecën në mënyrë të denjë siç e do Perëndia (Kol. 1:10).
3. JETA JONË DUHET TË MBUSHET ME KRISHTIN DHE JO ME VETEN TONË (Heb. 12:2-3). Duhet t'i përqendrojmë mendimet tona mbi Të (Kol. 3:2); e gjitha jeta jonë duhet të ketë Krishtin në qendër dhe të mos jetë egoizmi ynë në qendër. Kthimi e shpinës ndaj vetes sonë është kështu një fazë e nevojshme e transformimit tonë.
4. BINDJE NDAJ FJALËS SE PERENDISE (Gjo. 14:15,21; 15:10; 1 Gjo. 3:24). Bindja ndaj Perëndisë është më e mirë se sa të gjitha sakrificat (1 Samuelit 15:22). Si mund ta thërrasim Jezusin «Zot» dhe të mos bëjmë gjërat që

na thotë t'i bëjmë? (Luka 6:46). Liria e Frymës nuk është të bëjmë atë që na pëlqen, por të bëjmë atë që Atij i pëlqen. Bindja ndaj Fjalës ndriçon mendjet tona (Heb. 5:14). Duhet të dëshirojmë të bëjmë vullnetin e Perëndisë (Gjo. 7:17) dhe duhet të presim që të provohemi në këtë fushë të veçantë të gatishmërisë sonë (Zan. 22:1-18). Nuk duhet ta përcaktojmë asnjëherë bindjen ndaj Fjalës me termin «legalizëm». Legalizmi është që t'i shtosh diçka asaj që Perëndia kërkon për sa i përket shpëtimit dhe mënyrës së të jetuarit të jetës së krishterë.

5. **TE BESOSH TEK PERËNDIA DHE TE MBESHTETESH TEK AI PER ÇDO NEVOJE** (Heb. 11:8; Gjo. 14:1). Duhet të ecim nëpërmjet besimit (2 Kor. 5:7). Besimi është në një farë mënyrë dhuratë e Perëndisë, por në një kuptim tjetër është përgjegjësia morale e njeriut. Për këtë arsye Jezusi qorton dishepujt e Tij për mosbesimin e tyre (Mt. 8:26; Luka 24:25).

6. **TI SHERBESH TE TJEREVE PER DASHURINE E JEZUSIT** (Gal. 5:13; 2 Kor. 4:5; Kol. 3:23-24). Ai që vadit do të vaditet (Fja. 11:25). Asnjë besimtar nuk mund të rritet vetëm duke gëlltitur thjeshtë bekimet dhe duke mos i dhënë mos dhënë asnjëherë asgjë. Një figurë e famshme shpreh mirë këtë koncept: «Deti i Vdekur është i vdekur sepse merr gjithmonë gjithçka dhe nuk nxjerr asnjëherë asgjë jashtë».

7. **DISIPLINA E JETES TENDE** (1 Kor. 9:27). Vetëkontrolli është njëri nga fryti i Frymës (Gal. 5:23; 2 Pjet. 1:6). Besimtarit i thuhet të vendosi në vdekje veprat e mishit (Rom. 8:13; Kol. 3:5). Perëndia vepron tek ne nëpërmjet kësaj disipline (Heb. 12:6-7).

Prezantimi i përditshëm i trupit tonë përpara Perëndisë është e domosdoshme (Rom. 12:1-2). Duhet t'i rezistojmë djallit (Jak. 4:7), të durojmë dhe të mundim tundimin (Jak. 1:12). Kur gabojmë duhet ta rrëfejmë mëkatit dhe ta braktisim (Fja. 28:13).

### **Parime se si të rimarrin veten kur rrëzohemi**

Besimtarët nuk bëjnë kurrë hapa fals ose rrëzohen? Sigurisht që po. Mendo për Davidin, Pjetrin ose për njerëzit e tjerë të Perëndisë. Në çdo mënyrë është e rëndësishme t'i kërkojmë Perëndisë që të ristabilizojë nga frika për të mos rënë në disiplinën e Tij dhe në korrigjimin e Tij (Heb. 12:5-9). Këto janë zgjidhjet hyjnore:

#### **1. PERMBUSH PERGJEGJESITE E TUA**

a. Rrëfe dhe braktis të gjitha mendimet dhe veprimet që ti e di që janë jashtë vullnetit të Perëndisë (Fja. 28:13; 1 Gjo. 1:9).

b. Vendos në rregull gjërat me të tjerët, aq sa është e mundur (Mt. 5:23-24; Rom. 12:18).

c. Fal (Mt. 6:14-15; 18:35). Ji tolerant me të tjerët (Kol. 3:13). Mbulo për aq sa është e mundur gabimet e tjerëve me dashuri (1 Pje. 4:8; 1 Kor. 13:4-7).

d. Kthehu tek komunikimi me Perëndinë, me Fjalën dhe me lutjen në komunikim të plotë me besimtarët e kishës tënde lokale.

2. **VARI SHPRESAT TEK FITORJA E KRISHTIT.** Kërko që të ndërpresësh ciklet e përsëritshme të rënieve. Kujto që Zoti Jezus ka realizuar tashmë bazën për lirim të tanishëm nga fuqia e mëkatit në jetët tona.

a. Ai ka copëtuar fuqinë e natyrës mëkatore (Rom. 6:6) dhe e ka dënuar mëkatit në mish (Rom. 8:3); jemi liruar (Rom. 6:20). Kjo nuk do të thotë që natyra mëkatore është hequr ose çrënjësuar (Gal. 5:16-17; Rom. 7:21,23; Mt. 26:41), por fuqia e tij shpërdoruese, që kishte më parë, është anuluar.

b. Besimtarët nuk kanë më arsye që të tremben nga Satani. Ai u mund në kryq (Gjo. 12:31; 16:11), dhe dominimi i tij mbi besimtarët është copëtuar (Kol. 2:15; Heb. 2:14). Në çdo mënyrë na thuhet që t'i rezistojmë (1 Pje. 5:8-9; Jak. 4:7), dhe për t'i mos i dhënë mundësi (Efes. 4:27) që t'i dalim hapur tundimeve të tij (Mt. 26:41).

c. Bota nënkupton një sistem satanik vlerash, një ndikim dhe një moral fetar që janë armiqtë e të krishterit (1 Gjo. 2:15-16). E gjitha kjo nuk ka të bëjë me ata banorë të botës që Perëndia i do. Një sistem i tillë është dënuar nga Zoti ynë (Gjo. 12:31; 1 Kor. 11:32). Ai lutet për ne që të na mbrojë nga bota (Gjo. 17:15). Ne tashmë kemi fituar (1 Gjo. 4:4; 5:4).

## **Parime për përqendrimin personal**

Çdo besimtar duhet të kalojë kohë me Perëndinë çdo ditë. Jeta jonë është në komunikim intim me Zotin. Disa zakone të mira karakterizojnë besimtarin, jeta e të cilit do të përdoret dhe do të bekohet nga Perëndia.

1. **KOHË E QETË.** Veshi i dishepullit zgjohet duke dëgjuar zërin e Perëndisë (Isa. 50:4). Duhet të fillohet pjesa e parë e ditës me Atë (Marku 1:35). Mbrëmja ose pjesë të tjera të ditës mund t'i dedikohet studimit të Shkrimit dhe lutjes. Eksperiencia e shumë të shenjtëve të Shkrimit ashtu si dhe shembulli i Zotit tonë Jezus, konfirmon domosdoshmërinë për ta filluar ditën me Perëndinë. Kjo kohë i dedikohet rregullisht meditimit dhe takimit direkt me Perëndinë.

2. **LUTJA.** Shpëtimtari ynë tha: «që duhet të luteshin vazhdimisht» (Luka 18:1). Lutja nuk u bë një zgjedhje e lirë në jetën e Tij këtu mbi tokë dhe nuk duhet të jetë as për ne; por duhet të jetë brezi i shpëtimit i komunikimit me Perëndinë. N.q.s. nuk jemi duke marrë, është e mundur që nuk jemi duke u lutur (Mateu 7:7). Një fillim i rëndësishëm i çdo ditë është që t'i dorëzohet trupat tanë Zotit për qëllimit e Tij dhe të thërrasësh udhëheqjen e Tij për gjithë ditën.

3. **STUDIMI I FJALËS.** Shkrimet na janë dhënë nga Perëndia për të qenë ushqim për shpirtat tanë (Heb. 5:12-14; Ps. 19:10). Është e domosdoshme që «të hamë» Fjalën e Perëndisë (Jeremia 15:16). Si mund ta mbajë jetën e pastër një i ri besimtar? «Duke u kujdesur për të sipas fjalës tënde» (Ps. 119:9). Ekziston një kohë për çdo gjë: për meditimin e një pjese të vogël të Biblës në mëngjes; për një studim sistematik, si leximi i plotë i Biblës për një vit; për një studim special me argumente. Është e rëndësishme të jesh në gjendje ta lexosh Biblën vetëm dhe të nxjerrësh mësim për jetën e përditshme. Përveç kësaj mësojmë përmendësh, me gëzim, pjesët më të bukura! (Ps. 119:11).

4. **NJË DËSHMI QË VERSHON.** Perëndia na jep fuqinë që të jemi dëshmitarë të Jezu Krishtit në këtë botë (Veprat 1:8). Mënyra natyrale e dëshimit është ajo që të ndajmë me ata që na rrethojnë besimin tonë si mënyrë jete. Duke mposhtur turpin mund të flasim për Krishtin përpara atyre që na rrethojnë të cilët janë të humbur dhe i pret një përjetësi pa Krishtin.

## **Parime që i përkasin Kishës**

Zoti Jezu Krisht ka një dashuri të madhe për Kishën e Tij, me gjithë mangësitë e saj tokësore (Efes. 5:25). Kisha e Tij është e përbërë nga persona të çliruar. Ai do që të bashkohen së bashku në vende të ndryshme për të inkurajuar njëri-tjetrin, për të adhuruar Zotin, për të predikuar Fjalën e Tij dhe t'i binden urdhrave të Tij. Bibla nuk koncepton një besimtar të ndarë nga kisha e tij lokale dhe që rri për hesap të vet për të adhuruar Zotin. Një pjesë shumë e bukur mbi këtë argument gjendet aktivitetet normale dhe përgjegjësitë e kishës:

1. **PAGËZIMI.** Ky është rrëfimi publik i Zotit Jezu Krisht nga ana e besimtarëve të rinj (Vep. 8:36-37).

2. **MESIMDHENIA E APOSTUJVE.** Mësimi i dhënë i këtyre njerëzve është mbledhur për ne në Bibël, së bashku me atë të profetëve të Dhiatës së Vjetër, që është edhe ajo Fjala e Perëndisë. Predikimi dhe mësimi i Fjalës së Perëndisë në grupe besimtarësh të bashkuar është një nga mjetet e Perëndisë e përcaktuar për rritjen tonë. Ato formojnë një program sistematik për të dhënë udhëzime dhe për të inkurajuar studimin personal të Biblës.

3. **BASHKËSI.** Besimtarët janë të thirrur që të mos braktisin mbledhjet me besimtarët e tjerë (Heb. 10:25). Për ata që braktisin mbledhjet me besimtarëve është thënë që «nuk ishin tanët» (1 Gjo. 2:19). Izolimi dhe individualizmi nuk gjejnë vend në eksperiencën e shëndoshë të krishterë. Shiko sesi besimtarët e parë ishin gjithmonë së bashku (Vep. 2:44-47). Shiko mënyrën e dërgimit të pjesës më të madhe të letrave të Dhiatës së Re.

4. **THYERJA E BUKËS.** Kjo ka të bëjë me darkën përkujtimore të bukës dhe verës, e themeluar nga Zoti natën që

e tradhtuan (Luka 22:19-20). Ajo zbatohet nga besimtarët e parë (Vep.20:7; 1 Kor.11:23-24).

5. LUTJET. Është një kohë për tu bashkuar në lutje me besimtarët e tjerë siç është edhe një kohë për lutjen individuale (Vep. 1:14). Megjithatë, i jepet vlerë më e madhe lutjes së përbashkët (Mt. 18:19). Ngjarje të fuqishme kanë ndodhur kur besimtarët janë lutur së bashku.

Mbase ja ke dhënë veten tënde Krishtit si Shpëtimtarit dhe Zotit tënd. N.q.s. është kështu, ky është fillimi i drejtë; por tani duhet t'i përkushtohesh Atij në mënyrë që Ai të mund ta jetojë jetën e Tij tek ty, çdo ditë (Gal. 2:20). Në këtë mënyrë Ai do të jetë fitimtar tek ty dhe nëpërmjet teje.

### Pyetje - Mësimi 13

«Lindja e re» është vetëm fillimi i përgjegjësisë së re për besimtarin. Kjo sjell shumë privilegje dhe shumë përgjegjësi. Është e rëndësishme të kuptosh konceptet që vijojnë:

1. Jezu Krishti ka ardhur t'i japë atij që beson (zgjidh një përgjigje)
  - a. jetën e përjetshme
  - b. një jetë të bollshme në këtë jetë
  - c. fitoren mbi botën dhe mbi tundimet
  - d. të gjitha përgjigjet e mësipërme
2. Kur një person beson tek Jezu Krishti është e rëndësishme që (zgjidh tre përgjigje)
  - a. të ndryshojë personalitetin e tij
  - b. t'i rrëfejë Krishtin të tjerëve publikisht
  - c. të lërë zakone dhe shoqëri të dëmshme
  - d. të kërkojë ndihmë tek një besimtar i pjekur
3. Shkruaj me fjalët e tua 1 Korintasve 6:19-20.

Çfarë efekti ka mbi ty personalisht kjo pjesë?

4. Përcakto kyçet e jetës së krishterë fitimtare në vargjet që vijojnë:
  - a. Gjo. 14:21
  - b. Romakëve 12:1-2
  - c. 2 Korintasve 4:5
  - d. Efes. 5:18
  - e. Kol. 3:2
  - f. Heb. 11:6
5. Përgjigju duke nënvizuar E VËRTETË ose E GABUAR.
  - a. Është e mundur të mëkatojmë mbasi jemi bërë të krishterë. (E VËRTETË - E GABUAR)
  - b. Duhet të mëkatojmë. (E VËRTETË - E GABUAR)
  - c. Nuk ka asnjë dallim n.q.s. mëkatojmë ose jo, nga momenti që «ke shpëtuar je gjithmonë i shpëtuar». (E

VËRTETË - E GABUAR)

d. Nuk është e nevojshme që të rrëfejmë mëkatet tona mbasi jemi shpëtuar përderisa Perëndia na i ka falur të gjitha mëkatet të kaluarat, të tashmet dhe të ardhshmet. (E VËRTETË - E GABUAR)

6. Cila është pjesa e Perëndisë dhe cila është ajo e njeriut në falje dhe në rehabilitimin e besimtarit (1 Gjo. 1:9)?

7. Cilat veprime janë treguar në vargjet që vijojnë, të cilat thellojnë përqendrimin tonë personal dhe intimitetin tonë me Perëndinë?

Marku 1:35

Psalmi 119:9-11

Veprat 1:8

8. Cilat ishin pesë gjërat në të cilat besimtarët e parë ishin angazhuar aktivisht (Vep. 2:41-42)?

Cilat prej tyre janë bërë reale në jetën tënde të krishterë?

9. Çfarë mendon? Cilat kanë qenë rrethanat që të kanë shtyrë të bëhesh i krishterë? Cilat kanë qenë ndryshimet më domethënëse në jetën tënde, që kur ke lindur sërish?

10. Çfarë mendojnë të tjerët? Tako të paktën tre vetë gjatë kësaj jave dhe bëji atyre pyetjet e mëposhtme:

(1) Sipas jush, çfarë është më e rëndësishme për një të krishterë: të shkojë në qiell apo të ketë një jetë të bollshme këtu në tokë?

(2) Si do ta përshkruanit mënyrën se si duhet të jetojë një i krishterë i vërtetë?

(3) A besoni që është më e rëndësishme për një besimtar të angazhohet në një kishë lokale? Përse, ose përse jo?